

L I G J
Nr.8626, datë 22.6.2000

STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit.

Neni 2

Në kuptimin e këtij ligji:

1. “Paraplegjik” nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme.
2. “Tetraplegjik” nënkupton çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

Neni 3

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Ministria e Shëndetësisë parashikon çdo vit në buxhetin e shpenzimeve të saj fondet e nevojshme për kontrolle periodike vjetore nga mjekë të specializuar për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes.

Neni 5

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale.

Neni 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e

vogël”.

Neni 7

Personat juridikë, shtetërorë ose privatë që punësojnë të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përveç kritereve të përcaktuara në ligjin nr.7955, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, përfitojnë për çdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin, të barabartë në përqindjen e fuqisë punëtore të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ministria e Financave nxjerr aktet nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji.

Neni 8

Shteti favorizon arsimimin e të sëmurëve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe të institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 9

Shteti i përjashton të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për sigurimin shëndetësor dhe u jep atyre të drejtën e përfitimit falas të barnave për sëmundjen, pasojë e invaliditetit.

Neni 10

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që janë në gjendje të rëndë dhe në pamundësi për t’u paraqitur në institucionet shtetërore, përfitojnë shërbimin në banesë nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato procedura mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatorë dhe në kushte shtëpie. Ministria e Shëndetësisë nxjerr aktet nënligjore përkatëse për këtë qëllim.

Neni 11

Udhëtimi urban i të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, bashkë me shoqëruesin e tyre, bëhet falas në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat, ndërsa udhëtimi interurban rimbursohet nga shteti në masën 50 përqind të vlerës.

Neni 12

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me telefon. Ata paguajnë tarifat telefonike të nivelit të parë, favorizuar për popullsinë e përcaktuar në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përjashtohen nga tarifat e tjera. Diferencat paguhën nga shteti.

Neni 13

Shteti financoi veprimtaritë e organizuara nga shoqatat e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim në buxhetin e shtetit.

Neni 14

Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 15

Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave ligjore.

Neni 16

Administrata e Përgjithshme e Ndhmës dhe e Shërbimeve Sociale administron mjetet e përshtatura për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kriteret përcaktohen me rregullore nga Administrata e Përgjithshme e Ndhmës dhe e Shërbimeve Sociale.

Personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

Neni 17

Shteti merr përsipër trajtimin me përparësi me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 18

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit përcakton tarifat e reduktuara të konsumit të energjisë elektrike për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 19

Ministria e Shëndetësisë merr masa që në spitalet e nivelit të dytë dhe të tretë të përshtaten dhe të pajisen një deri dy dhoma për shtrimin eventual të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 20

Në vende publike (aeroporte, stacione treni, stadione, hotele etj.) krijohen mjedise për lëvizjen, qëndrimin dhe shërbimin për të sëmurët paraplegjikë sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.

Neni 21

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 6, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 19 të këtij ligji.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2670, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8627 datë 22.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHITESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR HEDHJEN E BAZAVE TË VEPRIMTARISË SIPËRMARRËSE””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për shtesën e financimit për projektin “Mbështetje për hedhjen e bazave të veprimtarisë sipërmarrëse””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2671, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE HUAJE

Në bazë të notave të shkëmbyera ne 4 maj 1994, midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës Shqiptare (Notat I) në respekt të zbatimit të fondit të kredisë ripërtëritëse (Fond Kredie) dhe të Fondit të Garancisë në kuadrin e projektit “Promovimi i Veprimtarisë Sipërmarrëse në Shqipëri”(Projekt), Deutsche Ausgleichsbank (DtA) dhe Banka Agrare (RCB) mbyllën më 20 qershor 1995, një marrëveshje huaje duke përfshirë një direktivë për zbatim (“Marrëveshja Origjinale e Huasë”).

Që nga 1 prill 1999 DEG u caktua nga Bundesministerium für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung (“BMZ”) në vend të DtA për të vepruar si agjentë i vetëm ekzekutiv, si përfaqësues i Qeverisë Gjermane brenda kuadrit të përshkruar.

Sipas ligjit nr. 8393 i datës 30 prill 1998 dhe dekretit nr. 2085 i datës 12 maj 1998 Agjensia për Administrimin e Kredive (ATK) u krijua si trashëgimtar i ligjshëm i RCB- së.

Në 25 maj/17 qershor, 1999 ATK dhe DEG nënshkruan një Amendament (Amendament të marrëveshjes origjinale të huasë (Marrëveshja Origjinale e Huasë dhe Amendamenti që këtej e tutje formojnë Marrëveshjen e Huasë”) sipas të cilës të dyja palët bëhen palët e reja kontraktuese dhe ekskluzive të Marrëveshjes Origjinale të huasë. Më 28 Tetor 1999, të dyja palët firmosën një Marrëveshje e cila zëvendëson Marrëveshjen e Huasë.

Nga ana e Qeverisë Shqiptare Ministria e Financave është institucioni kompetent për Projektin në fjalë.

Sipas letrës së datës 31 gusht 1999, Ministria e Financave deklaroi se është dakort me Notën e datës 17 mars, 1999 (Nota II) sipas së cilës Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeveria e

Republikës së Shqipërisë bien dakort për një zgjerim financiar të projektit.

Në përputhje me Marrëveshjen Originale të Huasë dhe një marrëveshje midis Qeverisë Shqiptare dhe Komisionit European për kanalizimin e fondeve të dhuruara nga EU – PHARE brenda kuadrit të promovimit të SME-ve nëpërmjet Ministrisë së Financave nga Banka e Kursimeve dhe RCB, një tjetër agjensi ndërmjetëse financiare, Qeveritë Shqiptare dhe Gjermane ranë dakort për t’ia transmetuar ekzekutimin e mëtejshëm të Projektit BIA-s. Pra, BIA, DEG dhe Ministria e Financave bien dakort në lidhje me Marrëveshjen e Re të Huasë.

BIA është shoqëri anonime e themeluar sipas ligjeve të Republikës Shqiptare me zyrë të regjistruar në Shqipëri; nëpërmjet aktiviteteve të saj BIA ekzekuton shërbime bankare komerciale. DEG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë me zyrë të regjistruar në Belvederestrasse 40,50933 Koln; qëllimi i saj është inkurajimi i investimeve private për zhvillimin edhe të vendeve të tjera partnere.

Neni 1 **Shuma dhe Qëllimi i Huasë**

1. Në përputhje me Marrëveshjen Originale të Huasë midis DtA dhe RCB-së, DEG do t’i japë hua BIA-s si hua të shlyeshme, kontributin gjerman ende të pa disbursuar në Fondin e Kredisë, shumën prej

2,876,942 DM

(me fjalë: dymilion e tetëqindeshtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e dy marka që këtej e tutje do të quhet (“huaja”)

Në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të Notave të I, huaja do të përdoret në mënyrë ekskluzive për specialistët e kualifikuar shqiptarë për ngritjen e bizneseve të tyre, e preferueshme për ata specialistë që kthehen nga Republika Federale e Gjermanisë ose që janë kthyer pas 1 janarit 1993, dhe që kanë qëndruar për disa vite në Gjermani për t’u trajnuar ose si të punësuar (“Të kthyerit”).

2.Në përputhje me Marrëveshjen Originale të Huasë shuma e huasë prej 2,123,058 DM është disbursuar nga DtA tek RCB si kontribut gjerman për krijimin e fondit ripërtëritës të kredisë. Sipas Marrëveshjes, Neni 5 të gjitha pagesat nga shpërbërja e Fondit të Kredisë së përmendur nga ATK tek DEG do të kalojnë menjëherë nga DEG tek BIA. Kështu, DEG do t’i japë hua në vazhdim BIA-s fondet e Kontributit Gjerman si hua të shlyeshme shumën prej:

2,123,058 DM

(me fjalë: dymilion njëqindnjëzetetremijë e pesëdhjetë e tetë)

(Gjendja e Huasë)

Gjendja e Huasë do të përdoret për t’iu dhënë hua specialistëve shqiptarë të kualifikuar rezidentë në Shqipëri për ngritjen e bizneseve të tyre (Të kthyerit dhe specialistët shqiptarë të kualifikuar tani quhen “Huamarrësit Finalë”)

Huaja dhe Gjendja e Huasë, së bashku formojnë shumën 5.000.000 DM- (me fjalë: pesë milion marka) e që tani do të formojnë “Kontributin e Parë Gjerman ”.

3.Për të finalizuar përmbajtjen e Notave të II, DEG do t’i japë hua tjetër BIA-s si hua të shlyeshme shumën prej

5.000.000 DM

(me fjalë: pesëmilion marka) (“Huaja e Dytë Gjermane”)

Në përputhje me paragrafin 1. Të Notave të II, Huaja e Dytë Gjermane do të përdoret në mënyrë ekskluzive në ngritjen e bizneseve për të Kthyerit.

4. Duke iu referuar paragrafit 1, paragrafit 3, kontributi total Gjerman në Fondin e Kredisë i përmendur në paragrafin 6, më poshtë, që përfshin shuma deri në një maksimum prej 10.000.000 DM, - (me fjalë: dhjetëmilion marka) (“Kontributi Gjerman”) do t’i jepen hua BIA-s nga DEG sipas Marrëveshjes së re të Huasë.

5. Duke u bazuar tek Nota I, Ministria e Financave ka disbursuar tek RCB- ja shumën prej 1,525,478 DM nga kontributi shqiptar prej 5,000,000 DM – (me fjalë: pesëmilion marka) në Fondin e

Kredisë.

Duke u bazuar tek marrëveshja Neni 5, të gjitha pagesat nga Fondi i Kredisë së shpërbërë nga ATK tek DEG do të kalojnë menjëherë nga DEG për tek BIA. Kështu, DEG do t'i disbursojë këto lloj fondesh të transferuara nga pala shqiptare (kontributi shqiptar e konkretisht nga Ministria e Financave) si një hua të shlyeshme BIA-s në shumën prej

1,525,478 DM

(me fjalë: njëmilion e pesëqindnjëzetepesë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë marka)

6. Brenda katër javëve pasi Marrëveshja e Re e Huasë të bëhet efektive, Ministria e Financave do të vendosi me BIA-n për gjendjen e kontributit Shqiptar ende të padisbursuar në Fondin e Kredisë, sipas Notave I, si hua e shlyeshme në shumën prej:

3,474,522 DM

(me fjalë: tre milion e katërqindeshtatëdhjetë e katër e pesëqind e njëzetedy marka)

Të dyja pagesat e përmendura më lartë konsiderohen si Kontribut Shqiptar ("Kontributi i Parë Shqiptar") në Fondin e Kredisë e kanë si qëllim ngritjen e bizneseve të Huamarrësve Finalë.

7. Duke u bazuar tek Nota e II dhe tek Huaja e Dytë Gjermane, Ministria e Financave do t'i transferojë BIA-s kontributin shqiptar shtesë në Fondin e Kredisë si Hua të shlyeshme shumën prej:

2,500,000 DM

(me fjalë: dy milion e pesë mijë marka) ("Kontribut i Dytë Shqiptar")

Kontributi Total Shqiptar në Fondin e Kredisë i përmendur më poshtë në paragrafin 6 poshtë përmbledh shumën në një maksimum prej 7,500,000 DM- (me fjalë: shtatë milion e pesëqindmijë marka) ("Kontributi Shqiptar"), i cili do t'i jepet hua BIA-s nga Ministria e Financave sipas Marrëveshjes.

Kontributi Shqiptar do të përdoret për ngritjen e bizneseve të Huamarrësve Finalë dhe nga Kontributi Shqiptar të paktën 51% do të përdoren për t'iu dhënë hua të Kthyerve për ngritjen e bizneseve të tyre.

8. Vendimet në lidhje me dhënien e huave që do t'ju jepen Huamarrësve Finalë për ngritjen e bizneseve të tyre, do të merren në përputhje me praktikat bankare ndërkombëtare dhe termat e biznesit të BIA-s.

Neni 2

Kushtet e huasë dhe shlyerja

1. BIA do të paguajë interesin prej 0.75 në vit (zero pikë shtatëdhjetë e pesë) për të gjitha shumat e disbursuara BIA-s dhe shumat e tërhequra nga BIA. Interesi debitohet në shumën përkatëse deri në ditën kur shlyerjet kreditohen në llogaritë e përmendura në nenin 9, paragrafi

2. Huatë (Huaja e Parë Gjermane, Huaja e Dytë Gjermane dhe Kontributi Shqiptar) do të kenë një afat prej 40 vjetësh, duke filluar që nga dita në të cilën huaja individuale disbursohet, ose shuma e parë e pjesshme e huasë individuale disbursohet. Dhjetë vitet e para do të jenë periudhe grace. Pas kësaj, huatë do të kthehen në 60 transha të barabarta dy herë në vit. Shumat e transhave do të përcaktohen 6 muaj para datës së parë të vlefshme. Programi i shlyerjes do të rregullohet në rastin e shlyerjes ose e shlyerjes së parakohshme ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 8. dhe nenin 4, paragrafi 4.

1. Data e disbursimit të parë të Huasë së Parë Gjermane siç specifikohet në paragrafin 1 dhe 2 do të jetë 14 gusht 1996.

2. Data e disbursimit të huasë së Dytë Gjermane siç specifikohet në paragrafin 1 dhe 2 dhe të jetë dita e disbursimit të huasë ose dita e disbursimit të parë të pjesshëm që debitohet në llogarinë e DEG-ut të specifikuar në nenin 9 paragrafin 1.

3. Data e disbursimit të Kontributit të Parë Shqiptar siç thuhet në paragrafin 1 dhe 2, është 5 nëntor 1996.

4. Data e disbursimit të Kontributit të Parë Shqiptar siç thuhet në paragrafin 1 dhe 2, është dita e disbursimit të huasë ose e disbursimit të parë të pjesshëm që debitohet në llogarinë e Ministrisë së Financave e specifikuar në nenin 9 paragrafin 1.

5. Pagesat e interesave dhe të principalit do të bëhen dy herë në vit për periudhën deri në 30

qershor ose 31 dhjetor çdo vit.

6. BIA mund ta shlyejë përpara huanë të plotë ose të pjesshme.

7. Ministria e Financave dot'i japw hua BIA –s Kontributin Shqipar të përcaktuar në nenin 1 paragrafi 5 në mënyrë ekskluzive sipas kushteve dhe afateve të Marrëveshjes së Re të Huasë.

Neni 3

Procedurat e disbursimit dhe njoftimi për disbursim

1. Pas marrjes së një njoftimi të shkruar nga BIA, DEG do të disbursojë Huanë e Parë Gjermane dhe Huanë e Dytë Gjermane të pjesshme ose të plotë në llogarinë e hapur nga BIA në Republikën Federale të Gjermanisë për këtë qëllim.

Në të njëjtën mënyrë, pas marrjes së njoftimit të shkruar nga BIA, Ministria e Financave do të disbursojë Kontributin e Parë Shqiptar dhe Kontributin e Dytë në llogarinë e hapur nga BIA në Republikën Federale të Gjermanisë për këtë qëllim.

BIA duhet të informojë DEG dhe Ministrinë e Financave për numrat e llogarive dhe të kodeve bankare para njoftimit të parë për disbursim.

2. BIA-s i lind e drejta për të kërkuar shumat e huasë nga DEG, kur shuma e tërhequr nga Ministria e Financave sipas klauzolës 5, paragrafit 1a) të Notave të II është transferuar në llogarinë e BIA-s dhr shumat që kërkohej mund t'i kalohen Huamarrësve Përfundimtar maksimumi brenda 2 muajve kalendarikë nga marrja e parave nga BIA.

3. BIA-s do t'i kalojë shumat e kërkuara për tek Huamarrësit Përfundimtarë pas paraqitjes së kontratave të blerjes, faturave ose dokumentave të tjera, kopjet e të cilave duhet të ruhen në dosjet e kredive. Në përputhje me nenin 11 (4) BIA duhet të informojë DEG për datën e cdo kalimi të shumave për tek Huamarrësit Përfundimtarë.

4. Nëse BIA nuk është në gjendje të kalojë një shumë të kërkuar para skadimit të afatit në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 dhe 3, të specifikuara në paragrafin 2, shumat e tilla duhet t'i kthehen mbrapsht DEG ose Ministrisë së Financave pa humbur kohë. Kjo klauzolë nuk i referohet Gjendjes së Huasë dhe Kontributit të Parë Shqiptar. Nëse shfaqen rrethanat e nenit 5 paragrafit 13, BIA do të kërkojë kthimin e fondeve nga Huamarrësit Përfundimtarë e do t'i dërgojë mbrapsht DEG dhe Ministrisë së Financave.

5. Së bashku me njoftimin e parë për disbursim BIA duhet të konfirmojë që të gjitha kërkesat janë përmbushur në përputhje me ligjet Shqiptare si dhe për të gjitha detyrimet që lindin nga kjo Marrëveshje. Kjo duhet të zbatohet në veçanti, duke respektuar rregullat e këmbimit valutor.

6. BIA duhet të informojë DEG dhe Ministrinë e Financave për emrat e personave që janë të autorizuar për ta përfaqësuar në ekzekutimin e Marrëveshjes, si dhe prova për firmat e tyre. Autorizimet e humbasin vlerën vetëm pasi DEG dhe Ministria e Financave i mohojnë ato.

7. Detyrimet që kanë DEG dhe Ministria e Financave sipas Marrëveshjes së Re të Huasë janë shumë të disponueshme nga Buxheti i Shtetit.

8. DEG dhe Ministria e Financave kanë të drejtë të refuzojnë disbursimet e shumave të kërkuara n.q.s:

a) BIA nuk përmbush detyrimet e shlyerjes kundrejt DEG dhe Ministrisë së Financave në datën e duhur, ose

b) BIA nuk përmbush detyrimet që lindin nga kjo Marrëveshje, ose

c) BIA nuk mund të konfirmojë që shumat e huasë tashmë të disbursuara janë përdorur në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, ose

d) Shfaqen rrethana të vecanta që pa marrë parasysh diskutimet dhe përpjekjet nuk mund të korigjohen e që rrezikojnë ose parandalojnë ndjeshëm përmbushjen e detyrimeve që BIA ka kundrejt DEG dhe Ministrisë së Financave në kuadrin e Marrëveshjes së Re të Huasë.

9. Nëse shfaqet një nga rrethanat e specifikuara në paragrafin 8 e nuk zgjidhet brenda kufirit të përcaktuar nga DEG, që duhet të jetë një periudhë minimumi prej 30 ditësh, DEG dhe Ministria e Financave mund:

Në rastin e pikave a), b) dhe ose d) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të huasë së zgjatur si dhe pagesat e të gjitha interesave që lindin dhe të tjera konflikte të kësaj Marrëveshje.

Në rastin e pikës c) të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave për të cilat BIA nuk mund të provojë që janë përdorur për qëllimet e duhura.

1. Disbursimi i shumave të specifikuara në paragrafin 5 të Nenit 1 duhet të kryhet në përputhje me paragrafin 1 deri 9 të këtij Neni nese nuk parashikohet ndryshe në paragrafin 5 të Nenit 1.

Neni 4

Administrimi i fondit të kredisë

1. Fondi i Kredisë do të administrohet nga BIA si një fond i veçantë dhe si i tillë duhet të administrohet veçantë nga transaksionet dhe fondet e tjera.

2. Shlyerjet (interesat dhe principalet) të paguara BIA-s nga Huamarrësit Përfundimtarë për huatë e ngritjes së biznesit të dhënë nga Huaja e Parë Gjermane, Huaja e Dytë Gjermane dhe Kontributi Shqiptar do të kreditohen në Fondin e Kredisë. Këto shlyerje duhet të përdoren për t'iu dhënë përsëri hua specialistëve shqiptarë të kualifikuar për ngritjen e bizneseve të tyre, e do të përbëjnë bazën për ripërtëritjen e Fondit të Kredisë. Fondet e përtërira mund të përdoren edhe për specialistët e kualifikuar shqiptarë që nuk kanë qëndruar në Republikën Federale të Gjermanisë.

3. Në përputhje me praktikat bankare nderkombëtare, BIA do të depozitojë në kushtet më të mira të mundshme dhe në çdo kohë stokun e kapitalit të papërdorshëm në DM ose USD. Interesi i fituar nga të tilla depozita do të kalojë tek Fondi i Kredisë pas marrjes nga BIA.

4. Në rast se Kontributi Gjerman në stokun e kapitalit të Fondit të Kredisë nuk mund të përdoret komplet ose pjesërisht sipas paragrafit 2 brenda 6 muajve në vazhdim të gjitha shumat që e kalojnë 3,500,000 DM (me fjalë: tre milion e pesëqind mijë marka) duhet t'i paguhet DEG-ut si një shlyerje principali e pazakontë. Kjo dispozitë është e vlefshme vetëm pas 1 janarit 2001.

Neni 5

Kushtet për huatë që do të përdoren për ngritjen e bizneseve

1. Kushtet e mëposhtme do të aplikohen në të njëjtën mënyrë si për Huanë Gjermane ashtu dhe për Kontributin Shqiptar dhe duhet të specifikohen në të dyja Marrëveshjet e Huasë së ngritjes së bizneseve që BIA do të firmosi me Huamarrësit Përfundimtarë.

2. Qëllimi

Fondi i Kredisë do të përdoret nga BIA për ngritjen e bizneseve të reja kudo në Shqipëri. Huatë do të përdoren për krijimin e ndërmarrjeve private të vogla dhe të mesme ose për ndërmarrjen e aktiviteteve private në fushën e profesioneve të pavarura (free-lancer). Të përjashtuara janë biznesi ushtarak dhe të tjera aktivitete diskriminuese.

Huatë do të jenë të disponueshme për t'iu përgjigjur kërkesave financuese afatgjatë si dhe për financimin e kapitalit të përdorshëm në një raport të përshtatshëm me atë të investimeve. Kostot e fushës private të Huamarrësve Përfundimtarë nuk do të financohen.

Llojet e investimeve që mund të financohen janë si më poshtë:

Ngritja e ndërmarrjeve të reja.

Ndërmarrjet e reja mund të krijohen si ndërmarrje private ose në çdo lloj formë tjetër të lejuara sipas Ligjeve shqiptare.

Ndërmarrja e firmave ekzistuese.

Në këtë rast ndërmarrësi do të marrë përsipër firmën me të gjitha aktivet e saj të prekshme dhe të paprekshme dhe të vazhdojë aktivitetin përkatës.

Partnerët aktivë në firmat ekzistuese.

Një investim aktiv merret përsipër nëse ndërmarrëse merr pjesë në drejtimin e firmës ekzistuese pa zotëruar të gjitha aksionet e firmës së përmendur.

Investimet për zgjerimin e firmave të reja.

Këto lloj investimesh mund të kryhen në fazën e krijimit të firmave psh. brenda tre viteve të para pas fillimit të biznesit.

Prioritet duhet t'i jepet financimit të krijimit të ndërmarrjeve të reja. Në të gjitha rastet duhet të sigurohet që financuesi vë në zbatim aktivitetin e vëretë të financuesit edhe nëse financuesi merr pjesë në vendimet e ndërmarrjeve nëse është bashkautorizues për drejtimin dhe përfaqësimin dhe n.q.s. mban 25% të kapitalit të partnerëve. Për ekzaminimin e autoritetit drejtues dhe për pjesën e fitimit edhe detajet e marrëveshjes së partnerëve janë vendimtare.

BIA do të japë hua për ngritjen e bizneseve në përputhje me principet e politikës së Republikës së Shqipërisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

3. Kushtet paraprake për të aplikuar

Ata që kanë të drejtën për të aplikuar janë personat e kualifikuar shqiptarë të cilët përse i përket aftësisë ndërmarrëse dhe eksperiencës profesionale janë të kualifikuar për Projektin në fjalë. Prova e përfart e kualifikimit duhet t'i paraqiten BIA-s.

Financimi është i lidhur vetëm me personin.

Nëse huaja do t'i japet një njësie ligjore duhet siguruar që kërkesat e aplikimit për marrje huaje janë të përmbushura nga personi fizik që aplikon. Marrëveshja e huasë midis BIA-s dhe njësisë legale mund të mbyllet atëherë kur provohet se aplikuesi që ka aksione është gjithashtu i përgjegjshëm për detyrimet e njësisë legale me të gjitha aktivet e saj.

Huatë jepen vetëm për qëllimin "ndihmo njerëzit që të ndihmojnë vetveten". Në këtë mënyrë duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat financiare të aplikuesit.

Do të financohen vetëm ato Projekte që përshtaten me mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit dhe rregullat e sigurisë në Shqipëri. Prioritet do t'i jepen Projekteve për gratë dhe atyre për mbrojtjen e mjedisit.

Financohen vetëm ndërmarrjet e regjistruara.

Nuk ekzistojnë të drejta legale për të tilla financime.

4. Shuma e Huasë dhe pagesa

Huaja do të jepet në shumën prej 80% e kostos së investimeve përkatëse. Qëllimi i huave është financimi i një pjese të projektit. Aplikuesi duhet të marrë pjesë në financim me të gjitha fondet e tij dhe/ose me fonde nga burime të jashtme deri në një masë të përafërt – si rregull të paktën të mbulojë 20% të shpenzimeve totale të Projektit të gjykuara korrekt.

Maksimumi i huasë do të jetë 150.000 DM.

Shuma e huasë do të varet nga karakteristikat speciale dhe funksionimi i mundshëm i Projektit të Huamarrësve Përfundimtarë, nga fondet vetjake të disponueshme si dhe nga situata financiare e aplikuesit. Plani i Biznesit dhe kapitali i përdorshëm janë të domosdoshme për ngritjen e bizneseve të reja dhe duhet të jenë në një marrëdhënie ekonomike të justifikuar nga fitimi i pritshëm BIA ruan të drejtën, nëse është e domosdoshme, të llogarisë është një herë koston e investimit total në të cilën bazohet huaja.

Pagesa do të jetë 100% nga shumën e huasë e aprovuar.

BIA ka të drejtën për të caktuar një herë interesin prej 1% për shërbimin e huasë së aprovuar.

BIA mund t'ia japë huanë ose shumën të pjesëshme furnizuesve, prodhuesve, shitësve huamarrësve të fundit etj, mbështetur në kërkesën e Huamarrësve Përfundimtarë.

5. Monedha

Huatë për ngritjen e bizneseve mund të kontraktohen në monedhë të huaj (p.sh. DM, USD, Lira italiane). Duke iu përmbajtur konvertimit të DM në monedhën përkatëse do të zbatohet kursi i këmbimit zyrtar i Bankës së Shqipërisë i ditës së disbursimit të huasë ose të shumave të pjesshme.

6. Norma e Interesit

Interesi i përcaktuar nga BIA për monedhën e zgjedhur do të jetë fiks ose i ndryshueshëm, por në çdo rast, 10% më i ulët se interesi i tregut, i cili do të rishikohet dy herë në vit nga DEG dhe BIA.

Interesi dot ë paguhet në katër transha.

7. Afati

Deri në 10 vjet.

Afati do të caktohet sipas kërkesave specifike të Projektit individual të aplikuesit. Në rast se

kërkohet financimi afat-shkurtër dhe afat-gjatë mund të ndahet në nën hua me afate të ndryshme.

8. Periudha grace/Shlyerja e principalit.

Mund të bihet dakord për një periudhë grace deri në 2 vjet.

Pas kësaj, huatë mund të shlyhen me këste mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore.

Huatë mund të shlyhen parakohe komplet ose pjesërisht në çdo kohë falas, pa qenë e nevojshme njoftimi paraprak.

9. Garancitë

BIA zotohet me përgjegjësi të plotë kundrejt DEG dhe BIA-s për akordimin e huave për ngritjen e bizneseve.

BIA do të kërkojë nga Humarrësit Përfundimtarë të gjitha llojet e garancive, sigurimeve etj, që janë konvencionale të disponueshme në sistemin bankar shqiptar në mbështetje të huasë individualë për ngritjen e bizneseve.

BIA i merr në konsideratë gjithashtu edhe aplikimet në rastet kur biznesi i planifikuar si dhe mundësitë ndërmarrëse të aplikuesit konsiderohen pozitive megjithëse nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme.

Kryesisht në rastet e mungesës ose të pamjaftueshmërisë së kolateraleve 65% e disbursimit të huasë sigurohet nga Fondi i Garancisë siç përmendet në Nenin 7 dhe 8.

10. Siguritë

Huamarrësi Përfundimtar merr përsipër brenda kuadrit të marrëveshjes me BIA-n që të sigurojë mjaftueshëm në përputhje me praktikën e biznesit në Shqipëri pronën aktuale dhe të ardhshme dhe garancitë për pjesën e pasiguruar të huasë. BIA do të quhet si përfutuese në dokumentat e sigurimeve, nëse është e mundur sipas Legjislacionit Shqiptar.

11. Procedura e Aplikimit

Aplikimet duhet të dërgohen tek BIA ose tek degët e saj. Një përfaqësues i DEG ose një nga përfaqësuesit e autorizuar, duhet të angazhohet në komitetin e kreditit konkretisht e procedimit të huasë.

Aplikimi duhet të paraqesë një vlerësim të Projektit, dhe për këtë arsye duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtme:

Curriculum Vitae në formë tabele

Kopjen e pasaportës dhe të lejes së qëndrimit në Republikën Federale të Gjermanisë (Për të kthyerit nga Republika Federale e Gjermanisë).

Trashëgimitë dhe/ose certifikatat e aktiviteteve (p.sh. Çertifikata të trajnimit, aktivitetet profesionale).

Përshkrimi i Projektit.

Parashikimi i fitimit dhe i humbjes.

Investimi dhe plani i financimit.

Dokumentet që tregojnë financimin e vërtetë (dokumente që tregojnë burimet vetjake, marrëveshje huash etj.)

Regjistrimi i një biznesi.

Si dhe merr përsipër:

Marrëveshjen e Blerjes.

Bilanci dhe Gjendja e Fitimit dhe e Humbjes së kompanisë.

12. Kushte të Tjera

Në lidhje me dhënien e huasë për ngritjen e bizneseve të reja, huamarrësi do të ketë si pikë referimi Kushtet e Përgjithshme të Bizensit së BIA-s. Para ngritjes së biznesit ose gjatë fazës së krijimit, Huamarrësi Përfundimtar mund të jetë i detyruar të marrë pjesë në seminare ose të tjera trajnime ose të ketë avantazhin e shërbimeve konsultuese të ofruara nga agjenci të përafërta. Akordimi i huave për ngritjen e bizneseve mund të jetë i kushtëzuar nga pjesëmarrja e suksesshme.

Huamarrësi Përfundimtar duhet të japë pëlqimin e tij në kuadrin e marrëveshjes së huasë me BIA-n, se BIA lejohet të pajisë DEG me dokumente përsa i përket situatës ekonomike dhe ecurisë së biznesit. Plus kësaj, një klauzolë e njëjtë duhet të përfshihet në çdo marrëveshje huaje me Huamarrësin Përfundimtar duke iu përmbajtur Nenit 12.

13. Qëllime të Projektit

Huatë do të përdoren në mënyrë ekskluzive për qëllimet e specifikuar. Shlyerja e tyre do të kërkohet nga BIA nëse:

Huamarrësi Final ka dhënë pohime false në lidhje me fakte të rëndësishme, ose ka fshehur fakte të cilat janë vendimtare duke iu përmbajtur dhënies së huave për ngritjen e bizneseve ose

Kushtet e kërkuara për dhënien e huasë për ngritjen e bizneseve, në mënyrë të njëpasnjëshme kanë ngecur së zbatuari ose

Huaja për ngritjen e bizneseve nuk është përdorur për qëllimin e duhur, ose nëse përdorimi i huasë për qëllimin e duhur e investimet e bëra mund të mos jenë konkretizuar nëpërmjet dokumenteve të përshtatshme brenda 6 muajve nga pagesa e huasë.

Humarësi Përfundimtar refuzon të përmbushë detyrimin e tij për të siguruar informacion ose refuzon kontrollin.

Neni 6

Fondi i garancisë

1. Në përputhje me Nenin 4 para I b) të Notave të I Qeveria Gjermane u angazhua për një kontribut financiar të pashlyeshëm për krijimin e fondit të garancisë në shumën prej 1,500,000 DM – (“Fondi i Garancisë”). Në 3 shtator 1996 dhe 29 nëntor 1996, DtA ka transferuar dy kontribute financiare të pashlyeshme në shumën totale prej 1,000,000 DM e cila i është kaluar ATK-së.

Në lidhje me këtë DEG angazhohet t’i transferojë BIA-s pjesën ende të padisbursuar të këtij kontributi financiar të sapopërmendur në shumën prej

500,000 DM

(me fjalë: pesëqindmijë marka)

brenda katër javëve pasi Marrëveshja e Re e Huasë të bëhet efektive.

2. Duke u bazuar në Notat e II DEG do t’i transferojë BIA-s në plus një kontribut të dytë financiar në shumën prej

500,000 DM

(me fjalë: pesëqindmijë marka)

brenda katër javëve pasi Marrëveshja e Re e Huasë të bëhet efektive, duke iu referuar pëlqimit të dhënë nga BMZ-ja.

3. Duke iu referuar Marrëveshjes përkatëse pagesat nga ATK do të transferohen tek DEG për tek BIA. Pra DEG do t’i japë BIA-s fonde plus në shumën prej

1,000,000 DM

(me fjalë: njëmilion marka)

4. Kontributi financiar i përmendur në paragrafin 1 dhe 2 do të akordohet nga DEG si përfaqësues i Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë me kusht që fondet përkatëse do të jenë të disponueshme nga Buxheti i Shtetit Gjerman.

5. BIA merr përsipër të përdorë kontributin financiar si stok kapitali për krijimin e Fondit të Gjermanisë të Garancisë me qëllim që të sigurojë garanci për të gjitha huatë që do të akordohen për ngritjen e bizneseve, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Re të Huasë. BIA do të sigurojë garancitë nga Fondi i Garancisë për huatë e ngritjes së bizneseve të sapopërmendur në përputhje me Nenin 7 dhe 8 të Marrëveshjes së Re të Huasë.

Neni 7

Administrimi i fondit të garancisë

1. Administrimi i Garancisë do të trajtohet nga BIA si një fond special dhe si i tillë do të administrohet veçant nga transaksionet e tjera, fondet e tjera dhe nga ndonjë biznes tjetër. Fondi i Garancisë, nëse është e nevojshme, përfaqësohet nga BIA në marrëdhëniet e jashtme.

2. BIA do ta depozitojë stokun e kapitalit të fondit të garancisë në kushtet më të mira të

mundshme në DM ose USD, në përputhje me praktikat bankare ndërkombëtare, me qëllim që të ruajë në çdo kohë stokun e kapitalit. Interesi që fitohet ng të tilla depozita do të transferohet në stokun e kapitalit brenda 3 ditë pune, pas marrjes nga BIA.

3. Sipas Nenit 5, paragrafit 6 nga interesi i paguar nga Huamarrësit Përfundimtarë fillimisht një shume që i korrespondon interesi prej 0.75% në vit do të transferohet tek DEG dhe Ministria e Financave sipas Nenit 2 paragrafit 1. Nga gjendja që ngelet 20% do të kalohet te stoku i kapitalit të Fondit të Garancisë menjëherë pas marrjes nga BIA se interesit të paguar nga Huamarrësi Përfundimtar. Pjesa e ngelur do të përdoret në përputhje me Nenin 16 (2).

4. Me qëllim përdorimin e Fondit të Garancisë në mënyrën më të mirë të mundshme, shuma totale e garancive të akorduara në prputhje me Nenin 8 paragrafi 2 do të jetë një multiplikator i stokur të kapitalit të Fondit të Garancisë. BIA do të mbulojë rrezikun e mbikalimit të stokut të kapitalit të Fondit të Garancisë.

5. Stoku i kapitalit i papërdorur do të ngelet tek BIA për aq kohë sa ekziston Fondi i Kredisë. Në momentin e mbylljes së Fondit të Kredisë, Ministria e Financave vendos për përdorimin e mëtejshëm të stokut të kapitalit të papërdorshëm të Fondit të Garancisë.

Neni 8

Kushtet e garancisë

1. Lloji dhe qëllimi i garancive:

Garancitë e dhëna në favor të BIA-s nga Fondi i Garancisë do të jenë garanci deficiiti për të mbuluar kapitalin dhe interesin për të gjitha huatë e dhëna nga BIA për ngritjen e bizneseve të reja sipas Marrëveshjes së Re të Huasë. Defiçiti përkufizohet si diferenca midis shumave që rezultojnë nga shtrëngimi i të gjitha sigurive të disponueshme dhe shumave të detyruara BIA-s sipas marrëveshjeve individuale për ngritjen e bizneseve të firmosura nga BIA së bashku me Huamarrësit Përfundimtarë sipas dispozitave të Marrëveshjes së RE të Huasë.

Garancitë mund të tërhiqen vetëm kur gjendet gabimi pas realizimit të të gjitha garancive të tjera brenda kuadrit të mundësive ligjore.

2. Shuma e garancisë

Në princip për të gjitha huatë e ngritjes së bizneseve të reja vetëm 65% të shumave të disbursuara sigurohen me anë të garancive në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Re të Huasë. Në rastin e mospërmblidhjes 10% të principalit dhe interesit të ngelur për t'iu paguar BIA-s do të mbeten nën përgjegjësinë e BIA-s pasi të rezultojë që të gjitha siguritë e vëna në dispozicion nga Huamarrësi Përfundimtar në favor të BIA-s janë realizuar. Gjendja e ngelur do të mbulohet me anë të garancive brenda kufijve të specifikuar më sipër.

Në përgjithësi, BIA nuk do të akordojë kryesisht për ato raste për të cilat nuk ka garanci të mjaftueshme dhe për rastet kur huatë e akorduara për ngritjen e bizneseve nuk janë të garantuara.

Për pjesën e huasë të garantuar nga Fondi i Garancisë, nuk është e nevojshme të sigurohen garanci nga Huamarrësi Përfundimtar as në favor të BIA-s as në favor të Fondit të Garancisë.

3. Dokumentet e Garancisë

Përveç këtyre kushteve nuk nxirret asnjë dokument tjetër garancie. Individit i Huamarrësit Përfundimtar nuk do të informohet rreth mbulimit të pjesshëm të huasë së tij nga këto dispozita.

4. Afati i Garancisë

Afati i Garancisë përkon me atë të huasë. Ndryshimet që ndodhin në afatin e huasë (p.sh. Rasti i shlyerjes së parakohshme ose zgjatja e huasë) automatikisht ndryshojnë dhe afatin e garancisë.

5. Procedura që ndiqet në rastin e falimentimit të Huamarrësit final

5.1. Përcaktimi i shkeljes së marrëveshjes

Në rast se Huamarrësi Final nuk përmbush detyrimet e tij nga kjo Marrëveshje Huaje me BIA-n dhe nga këta të fundit nuk gjendet ndonjë rrugë marrëveshje atëhere edhe huaja duhet të mbyllet, dhe të gjitha garancitë e disponueshme duhet të realizohen brenda mundësive ligjore. Pasi janë realizuar të gjitha garancitë dhe mbetet pa paguar ndonjë shumë nga principali dhe interesi atëhere BIA reklamon tek fondit i

Garancisë.

5.2. Reklamimi nga fondi i Garancisë

Çdo disbursim nga Fondi i Garancisë për tek BIA kërkon pëlqimin e shkruar të DEG. Për këtë qëllim të gjitha dokumentet e nevojshme do t'i vihen në dispozicion DEG sapo të përcaktohet shkela e marrëveshjes.

Në rastin kur Fondi i Garancisë i rimbursos BIA-s reklamimin që është njohur si shkelje, kjo regjistrohet në bilancin e BIA-s në të njëjtën kohë me pagesën e Fondit të Garancisë dhe administrohet nga BIA në favor të Fondit të Garancisë që atëhere e në vazhdim. Reklamimi nuk shfaqet për kohë të gjatë në bilancin e BIA-s por mbetet si reklamim ligjor i BIA-s në favor të Fondit të Garancisë kundër Huamarrësit Përfundimtar.

BIA ka disa mundësi për të mbuluar të tilla reklamime në favor të Fondit të Garancisë:

5.2.1. Këstet: BIA dhe Huamarrësi Përfundimtar bien dakord për një program të ri të shlyerjes në rast të mosgjetyes së ndonjë zgjidhjeje. Reklamimi i Fondit të Garancisë mbetet në fuqi deri sa të gjitha interesat e grumbulluara dhe principali të jenë paguar plotësisht. Nëse është e mundur mund të negociohet për një shlyerje të pjesshme në rastin e të cilit një pjesë e huasë dhe/ose interesit jepet me koston e Fondit të Garancisë. Të tilla shlyerje kërkojnë pëlqimin e shkruar në DEG.

5.2.2. Shtyrja: Reklamimi në favor të Fondit të Garancisë kundër Huamarrësit Përfundimtar ngelet në fuqi. Megjithatë BIA për një periudhë kohe të përcaktuar – në emër të Fondit të Garancisë - heq dorë nga e drejta e kërkuar reklamim kundër Huamarrësit Përfundimtar. Në një rast të tillë huaja zhvendoset në kohë p.sh. në një afat prej tre vjetësh. Pas këtij afati, gjatë së cilës reklamimi mban interesat sipas marrëveshjes së huasë për ngritjen e bizneseve, mundësitë e shlyerjes së Huamarrësit Përfundimtar rishikohen. Në rastet pozitive të shlyerjes, mund të bihet dakord për një rinovim të shtyrjes, ose për lirimin nga detyrimi.

5.2.3. Lirimi nga detyrimi: BIA heq dorë nga e drejta e saj në Fondin e Garancisë. Kjo e drejtë hiqet nga Fondi i Garancisë dhe e drejta kundrejt Huamarrësit Përfundimtar bie. Ky librim nga detyrimi kërkon aprovimin e shkruar të DEG.

5.3. Administrimi i reklamimeve të shtyra

Në rastet e reklamimeve të shtyra BIA inspekton rregullisht rrethanat ekonomike të debitorit. Nëse rrethanat ekonomike të debitorit e lejojnë, mund të bihet dakord për një rregullim të shlyerjes.

Neni 9

Pagesat

1. Detyrimet e pagesës të BIA-s do të përmbushen vetëm n.q.s. dhe deri në çfarë mase, pas zbritjes së të gjitha kostove dhe shpenzimeve, shuma respektive e së cilës do të kreditohet jo më vonë se ora lokale 9.00 a.m. në datën e duhur tek:

a) llogaria e bankës së DEG (Westdeutsche Landesbank Köln, Llogaria nr.707 16 65, Kodi Bankar 370 500 00, kodi Swift: West LB WELADE3K (me referencën tek “ELD-ALBANIA” me shënimin “Për qëllim Përdorimi”) në EURO/Deutscher Mark (marka), ose:

b) llogarinë e bankës së Ministrisë së Financave (Llogaria Nr.317/1700, Banka e Kursimeve, Njësia 2, Tiranë) në EURO/Deutscher Mark (marka).

ose në llogari të tjera të njoftuara nga BIA jo më vonë se 7 ditë para skadimit të afatit të detyrimit.

2. Ngritja e kundërreklamimeve kundër reklamimeve të DEG të shfaqura gjatë kësaj marrëveshjeje dhe të drejtës së BIA-s për të refuzuar pagesat nuk është e lejueshme.

3. Sipas nenit 10 për llogaritjen e interesit dhe të dëmeve të rëna dakord për pagesat që e kanë kaluar afatin e vitit do të llogaritet me 360 ditë dhe muaji me 30 ditë.

4. Ndonjë pagesë brenda kuadrit të Marrëveshjes së Re të Huasë do të kryhet pa zbritjen e taksave, kostove e transferimit dhe e shpenzimeve publike të tjera. Çdo taksë ose shpenzim publik që shfaqet pas mbylljes dhe zbatimit të marrëveshjes jashtë fushës Gjermane të zbatimit do të përballohet nga BIA siç specifikohet edhe në Notat e I.

5. Shumat e huasë të padisbursuara ose të shlyera para afatit kreditohen kundër transhes së fundit

të detyruar në përputhje me programin e pagesave, nëse nuk është rënë dakord ndryshe.

Neni 10 **Pagesat e vonuara**

1. Nëse pagesat nuk bëhen në datën e caktuar, penalteti i interesit do të jetë 3% mbi normën bazë të interesit (Basiszinssatz) sipas paragrafit I të ligjit Gjerman "Diskontsatz-Uberleitungsgesetz" i vlefshëm atë ditë e i llogaritur nga dita e caktuar për t'u bërë pagesa deri në ditën aktuale. Penalteti i interesit do të paguhet në datën tjetër të pagesës.

2. Sipas nenit 3 paragrafi 4, shumat e plota ose të pjesshme që nuk kthehen nga BIA në ditën e parë të javës së shtatë pas marrjes së parave nga BIA, do të paguhet përsëri me një ratë interesi prej 3% mbi normën bazë të interesit sipas paragrafit I të ligjit Gjerman "Diskontsatz-Uberleitungsgesetz" i vlefshëm atë ditë.

Neni 11 **Raportimi**

1. BIA zotohet për të mbajtur kontabilitetin financiar dhe të shpenzimeve dhe sistemin e kontrollit dhe të raportimit për Fondin e Kredisë dhe fondin e Garancisë dhe veprimet e BIA-s në anglisht si dhe zotohet për t'i dërguar DEG raport vjetor dhe gjysëm vjetor në anglisht. DEG mund të kërkojë raporte të tjera nëse aktiviteti i BIA-s nuk kryhet ashtu siç duhet.

2. BIA do të autorizojë Auditorët e saj, sipas modelit të Aneksit 3, për të informuar direkt DEG rreth situatës tregtare dhe financiare.

3. BIA do të njoftojë menjëherë DEG në lidhje me ndonjë incident që mund të ndodhë dhe që ndikon tek gjendja financiare ose tregtare e BIA-s ose tek qëndrimi i BIA-s për të përmbushur detyrimet sipas Marrëveshjes së Re të Huasë.

4. BIA zotohet për të informuar DEG dhe Ministrinë e Financave nëpërmjet raporteve 3 mujore ose dhe më shpesh sipas kërkesave, duke iu përmbajtur gjendjes së Fondit të Kredisë duke paraqitur p.sh. pagesat e marra nga DEG dhe Autoritetet Shqiptare, disbursimet e paguara si hua për ngritje biznesi, pagesat e marra si principal, interesat, dhe interesat e fituara nga depozitimi i fondeve të papërdorura të stokut të kapitalit të Fondit të Kredisë.

Këto raporte do të tregojnë p.sh. normat referuese të tregut, përdorimin e duhur të fondeve duke iu përmbajtur qëllimit (të Kthyerit dhe specialistët vendas shqiptarë) duke përfshirë informacion rreth kohëzgjatjes të huave të ngritjes së bizneseve, normën e interesit dhe shumën e garancive të marra, të shumave të ndryshme të huasë në përputhje me Nenin 1. BIA do t'i përpilojë këto raporte në përputhje me modelet e Aneksit 2, e cila mund të ndryshohet në një kërkesë formale të DEG.

5. Në të njëjtën mënyrë, BIA raporton rreth situatës së Fondit të Garancisë duke treguar p.sh. Pagesat e marra nga DEG, interesi i fituar nga depozitimi i stokut të kapitalit të Fondit të Garancisë si dhe garancitë e zbatuara për huatë e pjesshme ose të plota të papaguara.

6. Në përputhje me Nenin 4(3) dhe Nenin 7(2), BIA do të informojë me anë të raporteve 3 mujore rreth afateve të depozitave të stokut të kapitalit të papërdorur të Fondit të Kredisë dhe Fondit të Garancisë p.sh. Lloji i investimit, interesi, afati, monedha, bankën dhe numri i llogarisë së investimit.

7. Të gjitha transaksionet që do të raportohen si dhe informacioni rreth stokut të kapitalit të fondit të Kredisë dhe fondit të Garancisë do të konvertohen, nëse është e nevojshme, në marka me kursin përkatës zyrtar të Bankës së Shqipërisë i vlefshëm në ditën kur përfundohet transaksioni ose i vlefshëm në ditën e fundit të periudhës së raportuar. Diferencat e kursit të këmbimit do të raportohen si pikë më vete.

Neni 12 **Kontrolli dhe e drejta e inspektimit**

DEG, Ministria Federale e Bahkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik, si dhe Zyra Federale

Kontroluese e Republikës Federale të Gjermanisë, kanë të drejtën në çdo kohë të vetëkontrollohen, ose të kontrollohen nga një përfaqësues, për përdorimin e Fondit të Kredisë dhe të burimeve të Fondit të Garancisë nga ana e BIA-s dhe Huamarrësve Përfundimtarë. BIA do të informojë në lidhje me dokumentet e nevojshme si dhe përmbajtjen e dokumenteve (llogaria e humbjes dhe fitimit, bilancet) në lidhje me situatën ekonomike të projekteve të promovuara. Gjithashtu BIA, zotohet në lidhje me dhënien e huave dhe garancive Huamarrësve Përfundimtarë, për të detyruar Huamarrësin Përfundimtar dhe ndonjë Bankë të angazhuar si ndërmjetëse, për t'iu dhënë të drejtën e kontrollit, të drejtën e inspektimit të kompanisë si dhe detyrimin për të informuar rreth informacionit përkatës. Institucionet e lartpërmendura mund të kontrollojnë ndërmarrjet, e kërkojnë të drejtën për të pasur akses tek librat e Huamarrësve Përfundimtarë dhe tek të tjera dokumenta dhe mund të kërkojnë informacione shtesë.

Neni 13

Garancia e Republikës së Shqipërisë

Si garantues, Qeveria e Republikës së Shqipërisë zotohet me përgjegjësi të plotë për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të BIA-s që lindin nga kjo Marrëveshje kundrejt DEG respektivisht Qeverisë Gjermane në përputhje me klauzolën 5 paragrafi I(b) të Notave të I dhe klauzolën e Notave të II.

Neni 14

Arbitrimi

Konfliktet që lindin nga zbatimi i Marrëveshjes së Re të Huasë, duke përfshirë ato konflikte rreth vlefshmërisë së Marrëveshjes së Re të Huasë, do të jenë subjekt i arbitrit kur palët nuk merren vesh në mënyrë miqësore:

1. Palët nuk bien dakord për një arbitër individual atëhere, mund të formohet një Trup gjykues arbitrar i përbërë nga tre anëtarë që do të caktohen si vijon: një arbitër nga BIA, i dyti DEG dhe i treti (kryetari) nga marrëveshja midis palëve ose, nëse nuk arrihet një marrëveshje brenda 60 ditëve të marrjes së reklamimit të të akuzuarit, me kërkesën e një pale, nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Nëse nga palët nuk cakton arbitrin, atëhere arbitri caktohet nga kryetari.

2. Nëse arbitri i caktuar nuk përmbush detyrimin atëhere një tjetër arbitër caktohet në të njëjtën mënyrë si arbitri i mëparshëm. Ky arbitër i ri do të ketë të gjitha detyrimet dhe autoritetet e arbitrit të mëparshëm.

3. Në përputhje me paragrafin 1 për caktimin e arbitrave, nëse një nga palët reklamon për palën tjetër atëhere konflikti i drejtohet Trupit gjykues arbitrar. Reklamimi duhet të specifikojë llojin e reklamimit, kompensimin e dëshiruar dhe emrin e arbitrit të caktuar nga i akuzuari (I cili duhet të jetë i autorizuar).

4. Në përputhje me paragrafin 1 për caktimin e arbitrave, i akuzuari duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve të marrjes së reklamimit dhe duhet të njoftojë akuzuesin për emrin e arbitrit të caktuar nga ai vetë (I cili duhet të jetë i autorizuar).

5. Arbitri individual ose kryetari duhet të specifikojnë datën kur do të mblidhet gjykata e arbitrave. Nëse palët vetë nuk kanë specifikuar vendtakimin atëhere kjo caktohet nga Trupi gjykues arbitrar.

6. Trupi gjykues duhet të marrë një vendim përsa i përket kompetencave të tij. Trupi gjykues arbitrar duhet të përcaktojë vetë mënyrën e procedimit, të marrë parasysh principet e përgjithshme të njohura se si duhet të procedojë. Në ndonjë rast palëve iu duhet dhënë mundësia e argumentit gojor në një mbledhje të zakonshme. Trupi gjykues arbitrar gjithashtu mund të marrë vendim në rastin e shkeljes nga njëra palë. Të gjitha vendimet e Trupit gjykues arbitrar kanë nevojë dhe për mendimin e të paktën dy arbitrave.

7. Vendimi arbitrar shkruhet nga Trupi gjykues arbitrar bashkë me arsyet. Firmoset nga të paktën dy arbitra e konsiderohet që do të jetë vendimi arbitrar i Trupit gjykues arbitrar. Çdo pjesëmarrës do të marrë nga një kopje të firmosur. Pas firmosjes së Marrëveshjes së Re të Huasë, palët marrin përsipër për

t'iu nënshtruar vendimit arbitrar.

8. Palët duhet të specifikojnë shpërblimin e arbitrave dhe e personave që nevojitem për ekzekutimin e procedurave të arbitrit. Nëse palët nuk mund të bien dakord për shpërblimin para mbledhjes së parë atëherë, gjykata e arbitrave do të përcaktojë një shpërblim të arsyeshëm. Secila palë mbart në vetvete shpenzimet e tyre që lindin nga procedimet. Shpenzimet e Trupit gjykues arbitrar do të përballohen nga pala e pasuksesshme. Shpenzimet ndahen në mënyrë proporcionale nëse secila palë rezulton pjesërisht e suksesshme.

9. Vendimet e gjykatës së arbitrave në lidhje me të gjitha çështjet e shpenzimeve të procesit të arbitrit, janë vendimtare.

10. Palët do të jenë përgjegjës së bashku dhe veç e veç për shpërblimin e personave të përmendura në paragrafin 8.

Neni 15

Kushte të përgjithshme

Nëse DEG nuk bie ndryshe dakord BIA do të:

1. lejojë përfaqësuesit e autorizuar të DEG që të kenë akses tek aktivitetet e saj dhe në çdo kohë gjatë orarit normal të punës sipas një njoftimi të arsyeshëm, n.q.s. BIA nuk i nënshtrohet detyrimeve të Marrëveshjes së Re të Huasë ose nëse DEG ka prova të arsyeshme për të besuar se shërbimi i huave i BIA-s është në rrezik;

2. informojë DEG menjëherë për ndryshimet e qëllimit të krijimit të shkrirjes ose likuidimit e cila mund të rrezikojë ekzekutimin e projektit.

BIA konfirmon se i ka marrë të gjitha masat që software, hardware dhe aparatet e kontrollit automatik të procesit të mund të operojnë pa gabim gjatë dhe pas vitit 2000.

Neni 16

Kostot dhe shpenzimet

1. Asnjë taksë ose shpenzim publik që do të lindin nga BIA në veçanti kostot e transferimit dhe kostot e dhënies dhe administrimit të huave për ngritjen e bizneseve, nuk mund të financohen nga huatë e akorduara në përputhje me nenin 1 paragrafet 1,2,3 dhe 5.

2. Pas zbritjes së interesit 0.75% në vit pas Nenit 2(1) dhe transferimin e 20% të mbetjes në stokun e kapitalit të Fondit të Garancisë sipas Nenit 7(3), pagesa e ngelur e interesit e marrë nga Huamarrësit Përfundimtarë do të përdoret nga BIA për të mbuluar riskun e kursit të këmbimit, kostot e ekzekutimit të projektit përfshi shërbimin, këshillimin dhe konsultimin për Huamarrësit aktualë Përfundimtarë e potencialë, kostot e trajnimit dhe të këshillimit për nëpunësit e BIA-s që merren me projektin dhe kufirin e fitimit. Plus kësaj, BIA është e detyruar që të kryejë si vijon:

- printimin e broshurave të projektit

- masa të tjera për të promovuar projektin p.sh. Reklama të shpeshta në gazeta etj.

Neni 17

Ligji rregullues dhe juridiksioni

1. Marrëveshja e Re e Huasë do të rregullohet në përputhje me ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

2. Juridiksioni në lidhje me Marrëveshjen e Re të Huasë i mbetet Trupit gjykues arbitrar të krijuar në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë vendimi i të cilës është përfunduar siç specifikohet në Nenin 14.

Neni 18
Të ndryshme

1. Të gjitha korrespondencat në lidhje me këtë Marrëveshje do të dërgohen në formë të shkruar, në anglisht tek adresat përkatëse të palëve si vijon:

Për BIA:Per DEG
Banco Italo AlbaneseBelderestrasse 40
Ruga Barrikadave50 Koln (Mungersdorf)
Tirana, AlbaniaFederal Republik of Germany
Tel: 00355-42-33965Telefax: 0049-221-4986-290
Telefax: 00355-42-35700
Për Ministrinë e Financave
Ministria e Financave
Bul: “Dëshmorët e Kombit”
Tirana, Albania
Tel: 00355-42-284 05
Telefax: 00355-42-284 94

Secila palë merr përsipër për ta njoftuar palën tjetër për ndonjë ndryshim të adresave të tyre.

2. Çdo ndryshim ose amendament i kësaj Marrëveshjeje të Re huaje duhet të jetë e shkruar.

3. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje të Re Huaje është ose bëhet e pavlefshme për ndonjë arsye, vlefshmëria e dispozitave të ngelura nuk do të ndikohen. Në këtë rast Palët e Marrëveshjes së Re të Huasë duhet ta zëvendësojnë pa vonesë dispozitën e paefektshme me një dispozitë efektive ligjore që i përafrohet dispozitës së vlefshme.

4. Në rast se DEG dhe/ose Ministria e Financave nuk ushtrojnë të drejta që iu akordohen sipas Marrëveshjes së Re të Huasë, atëhere një mosushttrim i tillë nuk konsiderohet se përbën heqje dorë nga një e drejtë e tillë.

5. Kjo Marrëveshje e Re Huaje do të jetë efektive nëd atën e firmosjes së fundit dhe është efektive për aq kohë sa ka detyrime për t’u paguar DEG ose Ministrisë së Financave.

6. Kjo Marrëveshje e Re Huaje hyn në fuqi në datën e miratimit nga bordi administrues i BIA-s, ky miratim duhet t’iu njoftohet DEG dhe Ministrisë së Financave e shkruar.

L I G J
Nr.8628, datë 22.6.2000

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË, TË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRMES NDËRMARRJES SË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE, TË POGRADECIT DHE KFW-SË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“RUAJTJA E MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT DHE E UJËSJELLËSIT TË
POGRADECIT””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë, financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përmes Ndërmarrjes së Ujësjiellës-kanalizimeve të Pogradecit dhe KfW-së për financimin e projektit “Ruajtja e mjedisit të Liqenit të Ohrit dhe e Ujësjiellësit të Pogradecit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2672, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE HUAJE, FINANCIMI DHE PROJEKTI

Datë

Midis KREDITANSTALT FÜR WIDERAUBAU, Frankfurt am Main,

(KfW)

dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(Huamarrës)

e përfaqësuar nga

MINISTRIA E FINANCËVE

Si dhe

NDËRMARRJES SË UJËSJIELLËS- KANALIZIMEVE, Pogradec

(Agjencia e Ekzekutimit të Projektit)

për

9.550.000,00 DM hua dhe

12.850.000,00 DM kontribut financiar (Grant)

Ruajtja e Mjedisit të Liqenit të Ohrit

Ujësjiellësi i Pogradecit

Në bazë të një marrëveshje ende për t'u përfunduar midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (marrëveshje qeveritare), Huamarrësi, Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW hyjnë në marrëveshjen e mëposhtme të Huasë, Financimit dhe Projektit .

Neni 1

Shuma dhe Qëllimi

1.1 KfW do t'i japë Huamarrësit në shumën

9.550.000,00 DM dhe

Kontribute financiar jo më shumë se :

(a) 12,850,000.00 DM (investime).

Kontributet financiare nuk do të rikthehen përveç rastit kur parashikohet ndryshe nga neni 4.2.

1.2 Huamarrësi do t'ia kalojë huanë dhe kontributin financiar agjencisë së ekzekutimit të projektit në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e ekzekutimit të projektit do ta përdorë huanë dhe kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e Mbrotjtjes së Mjedisit të Liqenit të Ohrit dhe

Kanalizimeve të Pogradecit ne radhe të parë të paguajë koston e huaj . Agjencia e ekzekutimit të projektit dhe KfW do të vendosin detajet e projektit si dhe mallrat dhe shërbimet për t'u financuar nga Huaja dhe Kontributet Financiare nëpërmjet një marrëveshje të veçantë .

1.3 Taksat dhe detyrime të tjera publike që duhen të përballohen nga Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe taksat e importit nuk do të financohen nga huaja ose kontributet financiarë .

Neni 2

Kanalizimi i Huasë dhe Kontributet financiarë ndaj Agjencise se Ekzekutimit të Projektit

2.1 Huamarrësi do t'ia kanalizojë Huanë Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit nëpërmjet një marrëveshje të veçantë huaje me termat dhe kushtet e përcaktuara në nenet 4.2 dhe 4.4 me poshtë .

2.2 Huamarrësi do t'ia kanalizojë Kontributet Financiare në Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit si grante të pakthyeshme nëpërmjet një marrëveshje të veçantë financimi .

2.3 Përpara disbursimit të parë nga Huaja dhe Kontributet Financiare, Huamarrësi do të dorëzojë në KfW një kopje të marrëveshjeve të referuara në nenit 2.1 dhe 2.2 .

2.4 Kanalizimi i Huasë dhe i Kontributeve Financiare nuk përbën detyrim për Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit ndaj KfW për kthim sipas kësaj Marrëveshje .

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW do të disbursojë Huanë dhe Kontributet Financiare në përputhje me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit. Me anë të një marrëveshje të veçantë, Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në vëçanti evidencën që provon se fondet e tërhequra janë përdorur për qëllimin e shprehur .

3.2 KfW ka të drejtën të refuzojë disbursimet pas 30 dhjetorit 2006 .

Neni 4

Taksa e angazhimit, Interesi dhe Kthimi i Huasë

4.1 Huamarrësi do të paguajë taksën e angazhimit prej 0.25% në vit mbi shumat e padisbursuara të Huasë . Taksa e angazhimit do të llogaritet do të llogaritet për një periudhë që fillon 3 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe përfundon në datën në të cilën disbursimet debitohen .

4.2 Huamarrësi do të paguajë interes mbi Huanë 0.75% në vit. Interesi do të ngarkohet nga datat në të cilat disbursimet janë debituar në datuar në datat në të cilat kthimet janë kredituar në llogarinë e KfW të specifikuar në nenin 4.9.

4.3 Huamarrësi do të paguajë taksën e angazhimit, interesin sipas nenit 4.5 çdo gjysëm viti në 30 Qershor dhe 30 Dhjetor për gjysmën e vitit që mbaron aty. Taksa e parë e angazhimit detyrohet bashkë me pagesën e parë të interesit .

4.4 Huamarrësi do të paguajë Huanë si vijon :

1. 30 Qershor 2010 160,000.00 DM
2. 30 Dhjetor 2010 160,000.00 DM
3. 30 Qershor 2011 160,000.00 DM
4. 30 Dhjetor 2011 160,000.00 DM
5. 30 Qershor 2012 160,000.00 DM
6. 30 Dhjetor 2012 160,000.00 DM
7. 30 Qershor 2013 160,000.00 DM
8. 30 Dhjetor 2013 160,000.00 DM
9. 30 Qershor 2014 160,000.00 DM
10. 30 Dhjetor 2014 160,000.00 DM

11. 30 Qershor2015 160,000.00 DM
12. 30 Dhjetor2015 160,000.00 DM
13. 30 Qershor2016 160,000.00 DM
14. 30 Dhjetor2016 160,000.00 DM
15. 30 Qershor2017 160,000.00 DM
16. 30 Dhjetor2017 160,000.00 DM
17. 30 Qershor2018 160,000.00 DM
18. 30 Dhjetor2018 160,000.00 DM
19. 30 Qershor2019 160,000.00 DM
20. 30 Dhjetor2019 160,000.00 DM
21. 30 Qershor2020 160,000.00 DM
22. 30 Dhjetor2020 160,000.00 DM
23. 30 Qershor2021 160,000.00 DM
24. 30 Dhjetor2021 160,000.00 DM
25. 30 Qershor2022 160,000.00 DM
26. 30 Dhjetor2022 160,000.00 DM
27. 30 Qershor2023 160,000.00 DM
28. 30 Dhjetor2023 160,000.00 DM
29. 30 Qershor2024 160,000.00 DM
30. 30 Dhjetor2024 160,000.00 DM
31. 30 Qershor2025 160,000.00 DM
32. 30 Dhjetor2025 160,000.00 DM
33. 30 Qershor2026 160,000.00DM
34. 30 Dhjetor2026 160,000.00 DM
35. 30 Qershor2027 160,000.00 DM
36. 30 Dhjetor2027 160,000.00 DM
37. 30 Qershor2028 160,000.00 DM
38. 30 Dhjetor2028 160,000.00 DM
39. 30 Qershor2029 160,000.00 DM
40. 30 Dhjetor2029 160,000.00 DM
41. 30 Qershor2030 160,000.00 DM
42. 30 Dhjetor2030 160,000.00 DM
43. 30 Qershor2031 160,000.00 DM
44. 30 Dhjetor2031 160,000.00 DM
45. 30 Qershor2032 160,000.00 DM
46. 30 Dhjetor2032 160,000.00 DM
47. 30 Qershor2033 160,000.00 DM
48. 30 Dhjetor2033 160,000.00 DM
49. 30 Qershor2034 160,000.00 DM
50. 30 Dhjetor2034 160,000.00 DM
51. 30 Qershor2035 160,000.00 DM
52. 30 Dhjetor2035 160,000.00 DM
53. 30 Qershor2036 160,000.00 DM
54. 30 Dhjetor2036 160,000.00 DM
55. 30 Qershor2037 160,000.00 DM
56. 30 Dhjetor2037 160,000.00 DM
57. 30 Qershor2038 160,000.00 DM
58. 30 Dhjetor2038 160,000.00 DM
59. 30 Qershor2039 160,000.00 DM
60. 30 Dhjetor2039 160,000.00 DM

Total 9.550.000.00

4.5. Nëse kthimet e kësteve nuk janë në dispozicion të KfW kur janë të detyruara, KfW do të ketë të drejtën të rrisë përqindjen e interesit në përqindjen e Deutsche Bundesbank të asaj kohe plus 3% në vit për periudhën që fillon me datën e detyrimit dhe përfundon në datën në të cilën të tilla kthime kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 4.9 më poshtë. Në rastin e Arrears të interesit, KfW mund të kërkojë shpërblim dëmi. Të tilla dëme nuk do të kalojnë shumën e arritur nëse interesi do të ishte ngarkuar në të tilla arrears interesi në përqindjen e Deutsche Bundesbank në datën e detyruar plus 3% në vit.

4.6. Taksa e angazhimit, interesi dhe ndonjë takse mbi arrears sipas nenit 4.5 do të llogaritet mbi bazën e 360 ditë dhe 30 ditë në muaj.

4.7. Shumat e kthyer te pamaturuara ose të padisbursuara do të kreditohen në përpjestime të barabarta kundër të gjitha kësteve të papaguara përveç rastit kur KfW përcakton një mënyrë të ndryshme në një rast të veçantë, veçanërisht në rastet e shumave të një volumi më të vogël.

4.8 KfW ka të drejtën të kreditojë në diskrecionin e saj, pagesat e marra kundrejt pagesave të detyruara sipas kësaj marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër të përfunduar midis KfW dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi do kërkojë të gjitha pagesat ekskluzivisht në DM në llogarinë e KfW No. 22 1257 8894 duke mos pranuar kundërkërkesa mbi këto pagesa.

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe pagesat e pamaturuara

5.1 Huamarrësi në çdo kohë mund :

a) Të anulojë ndonjë shumë të huasë të padisbursuara ende, sipas përmbushjes së detyrimeve të tij të nenit 8, dhe

b) të kthejë Huanë tërësisht ose pjesërisht përpara maturimit.

5.2 KfW nuk mund të pezullojë disbursojë përveç kur:

a) Huamarrësi nuk ka kryer detyrimet e tij ndaj KfW për të bërë pagesat kur kanë qenë të detyruara,

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që kanë lidhje me këtë lidhje me këtë marrëveshje janë shkelur,

c) Agjencia e Ekzekutimit të Projektit është e paaftë të provojë që shumat të kredisë dhe Kontributeve të tjera Financiare të jenë përdorur për qëllimin e shprehur, ose

d) dalin rrethana të jashtëzakonshme të cilat pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit, ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të ndërmarra nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje.

5.3 Nëse ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 5.2 a), b), c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda periudhës së përcaktuar nga KfW, e cila sidoqoftë do të jenë të paktën 30 ditë, KfW mund,

a) në rastet e specifikuar e specifikuar në nenin 5.2 a), të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjithë shumës së papaguar të huasë si dhe pagesën e të gjithë interesit dhe taksave të tjera të rastit.

b) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 b), të kërkojë kthimin e menjëhershëm të Kontributeve Financiare dhe gjithë shumën e Huasë së papaguar si dhe pagimin e gjithë interesit dhe të taksave aksidentale;

c) në rastin e specifikuar në nenin 5.2 c), të kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumave të tilla të Huasë dhe të Kontributeve Financiare nëse Agjencia e Ekzekutimit të Projektit është e paaftë të provojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 6

Kosto dhe taksat publike

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat dhe detyrime të tjera publikeqë do të ndodhin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe gjithë koston e transferimit dhe konvertimit që ndodhin në lidhje me disbursimet.

Neni 7

Vlefshmëria e huasë, Financimi dhe Marrëveshja e Projektit dhe Përfaqësimi i Pushtetit

7.1 Sipas radhës së duhur para disbursimit të parë , Huamarrësi do t'i dorëzojë KfW-së evidencë të kënaqshme për KfW që provon se Huamarrësi ka plotësuar të gjitha kërkesat sipas ligjeve të tij për një supozim të vlefshëm të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.2 Ministri i Financave dhe persona të tjerë të caktuar prej tij dhe të autorizuar për të nënshkruar duke u autentifikuar prej tij do ta përfaqësojnë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Drejtori i Ndërmarrjes së Kanalizim-Ujësjiellësit të Pogradecit dhe persona të caktuar prej tij me të drejtë nënshkrimi të autentifikuar nga ai do të përfaqësojnë Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Prokurat nuk do të skadojnë deri në revokimin e tyre të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në kohën që është nga KfW.

7.3 Amendamente ose shtesa kësaj marrëveshje dhe ndonjë lajm ose dokument i dërguar nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshje do të bëhen me shkrim. Ndonjë lajm i tillë ose dokument do të jetë marrë menjëherë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese korresponduese ose në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese korresponduese siç është lajmëruar nga pala tjetër kontraktuese.

Për KfW: Kreditanstalt für Wiederaufbau Për Huamarrësin: Ministria e Financave

Postfach 1111 41 Bul. Dëshmorët e Kombit

D-60046 Frankfurt am Main Tirana . Albania.

Federal Republic of Germany Telefax:(355-42) 23558

Telefax:(69)7431-29 44

Telex: 415 25 60

Për Agjencinë e Ekzekutimit të projektit: Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimit Pogradec POGRADEC, Albania.

7.4 Amendamentet e kësaj marrëveshje që prekin vetëm marrdhëniet ligjore midis KfW dhe Huamarrësit nuk do të kërkojnë pëlqimin e Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit.

Neni 8

Projekti

8.1 Agjencia e Ekzekutimit të Projektit

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mbajë Projektin në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike dhenë përputhje me konceptimin e projektit midis Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit dhe KfW .

b) do të ngarkojë me përgatitjen dhe mbikqyerjen ekzekutimit të projektit inxhinierike konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe me zbatimin e projektit fiarma të kualifikuara.

c) do të lidhë kontratat për mallra dhe shërbime për t'u financuar nga huaja dhe kontributi Financiar nëpërmjet tenderit parapak ndërkombëtar publik dhe kontratat për t'u financuar nga kontributi Financiar.

d) do të mbajë ose do të bëjë që të mbahen libra dhe regjistra që tregojnë pa ekuivok të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të financuara nga kjo Hua dhe Kontributet Financiare;

e) do të mundësojë përfaqësuesit e KfW në çdo kohë të inspektojë këto libra dhe regjistra dhe ndonjë dokumentacion tjetër të zbatimit të projektit dhe të vizitojë projektin dhe të gjitha instalimet e tjera dhe

f) do t'i dorëzojë KfW-së çdo informacion dhe regjistrime mbi Projektin dhe progresin e mëtejshëm siç mund të kërkojë KfW.

8.2 Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe KfW do të vendosin detajet e përcaktuara në nenin 8.1 me një marrëveshje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Projektit do të:

a) do të sigurojë financimin e plotë të Projektit dhe me marrjen e kërkesës do t'i dorëzojë KfW evidencë që provon se të gjitha kostot e papaguara nga kjo Hua dhe Kontributet Financiare janë mbuluar dhe,

b) do të informojë KfW-në për ndonjë rrethanë që pengon ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin e qëllimin e projektit.

8.4 (a) Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit në përputhje me praktika të shëndosha financiare dhe inxhinierike në zbatimin e Projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshje.

(b) përpara disbursimin të parë të fondeve të projektit për mallrat dhe shërbimet do t'i dorëzojë KfW evidencë të kënaqshme që provon që të gjitha detyrimet e Agjencisë së Projektit ndaj KESH-it deri në 31 Dhjetor 1999 janë marrë nga Qeveria e Shqipërisë.

8.5 Për transportin e mallrave për t'u financuar nga Huaja dhe Kontributet Financiare do të aplikohet dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare që njihen nga Huamarrësi.

Neni 9

Dispozita të ndryshme

9.1 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të paprekura. Nëse rezulton ndonjë boshllëk, ai do të mbushet nga ndonjë dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.2 Huamarrësi dhe Agjencia e ekzekutimit të Projektit nuk mund të ngarkojë ose transferojë, verë peng ose hipotekë ndonjë të drejtë nga kjo Marrëveshje.

9.3 Kjo Marrëveshje do të qeveriset nga ligji i RFGJ. Vendi i lidhjes së marrëveshjes do të jetë Frankfurt mbi Main. Në rast të ndonjë dyshimi për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti gjerman do të mbizotërojë.

9.4 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kjo marrëveshje mbi vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe asaj të Arbitrimit që nuk mund të zgjidhen miqësisht midis palëve kontraktuese do t'i nënshtrohen procedurave të arbitrazhit në përputhje me Marrëveshjen e Arbitrazhit që përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

9.5 Kjo Marrëveshje Huaje, Financimi dhe Projekti nuk do të hyjë në fuqi derisa të hyjë në fuqi Marrëveshja Qeveritare në të cilën ajo do të bazohet.

E bërë në 6 origjinalë, në gjermanisht dhe 3 në anglisht.

Tiranë, më

KfWRepublika e Shqipërisë e përfaqësuar

Nga Ministria e Financave

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Pogradec

MARRËVESHJE ARBITRAZHI

Datë

Në reference të nenit 9.4 të Marrëveshjes së Huasë, Financimit dhe Projektit

Midis
KfW, Frankfurt mbi Main
Dhe
Republikës së Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave
(huamarrësi)
si dhe
Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve Pogradec
(Agjencia e Zbatimit të Projektit)
KfW, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit bien dakord si më poshtë :

Neni 1

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga kjo Marrëveshje Huaje, Financimi e Projekti dhe për vlefshmërinë e kësaj Marrëveshje Huaje ose Arbitrazhi që nuk mund të zgjidhet miqësisht nga palët kontraktuese do të zgjidhet përfundimisht nga Arbitrazhi.

Neni 2

Palët në arbitrazh do të jenë KfW dhe Huamarrësi e Agjencia e Zbatimit të Projektit nga ana tjetër. KfW ka të drejtën të ngrejë padi ndaj Huamarrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit veç ose bashkërisht. Në të njëjtën mënyrë, Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit (AZP) kanë të drejtën të ngrenë padi veç ose bashkë ndaj KfW.

Neni 3

3.1 Arbitrazhi do të përbëhet nga 3 arbitra të emëruar si më poshtë: një arbitër do të emërohet nga KfW, një nga Huamarrësi vetëm, ose nëse Huamarrësi nuk ka ndërhyrë, nga AZP dhe një i tretë (kryetar) do të emërohet me marrëveshje të palëve, dhe nëse palët nuk bien dakord brenda 60 ditëve pas marrjes së kërkesës për arbitrim nga i padituri, do të bëhet aplikimi i ndonjërës palë në ICC ose Komitetin Kombëtar Zvicerian të ICC. Nëse ndonjë palë nuk ka caktuar arbitrin e vet, ky do të caktohet nga Kryetari .

3.2 Në rast se ndonjë nga arbitrat jep dorëheqjen ose bëhet i paaftë të veprojë si arbitër, pasardhësi i tij do të emërohet në të njëjtën mënyrë si arbitri i parë. Pasardhësi do të ketë të njëjtat kompetenca dhe detyra si arbitri i parë.

Neni 4

Procedurat e arbitrazhit do të fillojnë me dërgimin e një kërkesë të shkruar nga njëra palë ose tjetra. Kjo deklaratë do të përmbajë natyrën e pretendimit, kompensimin e kërkuar dhe emrin e arbitrit të emëruar, me kusht që pretenduesi të ketë të drejtën të emërojë një arbitër sipas nenit 3.1.

4.2 Brenda 30 ditëve pas marrjes të kësaj deklarate, i padituri do të lajmërojë paditësin për emrin e arbitrit të emëruar nga ai, me kusht që mbrojtësi të jetë i autorizuar të emërojë një arbitër sipas nenit 3.1.

Neni 5

Arbitrazhi do të ndërhyjë në kohën që do të fiksohet nga Kryetari .Derisa palët nuk kanë rënë dakord për vendin e arbitrazhin, ky vend do të përcaktohet gjithashtu nga Kryetari.

Neni 6

Arbitrazhi do të vendosë më kompetencën e tij. Ai do të vendosë procedurat e tij në përputhje me

rregulla përgjithësisht të pranuar të procedurës. Në ndonjë rast të dyja palët do të marrin pjesë në një seancë gojore. Arbitrazhi sidoqoftë, mund të arrijë në përfundim pavarësisht nga ndonjë mungesë e ndonjë pale. Të gjithë vendimet e Arbitrazhit do të kërkojnë miratimin e të paktën 2 arbitrave.

Neni 7

Arbitrazhi do të japë vendimin bashkë me arsyetimin me shkrim. Një vendim i marrë nga të paktën 2 arbitra do të përbëjë vendimin e Arbitrazhit. Secila palë do të marrë një kopje të firmosur të vendimit .Vendimi do të jetë i detyrueshëm dhe final. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje të dyja palët do të marrin detyrimin për t'iu përmbajtur këtij vendimi.

Neni 8

8.1 Palët do të bien dakord për shpërblimin e arbitrave dhe këta persona do të kërkohen për të kryer procedurat e arbitrimin .

8.2 Nëse palët nuk bien dakord përpara se Arbitrazhi të mblidhet , Arbitrazhi do të fiksojë një pengesë të përshtatshme. Çdo palë do të mbulojë kostot e veta që rrjedhin nga arbitrazhi. Kostot e Arbitrazhit do të mbulohen nga pala kundër të cilës është dhënë vendimi. Nëse asnjë nuk merr vendim të plotë pro, kostoja do të ndahet proporcionalisht .

8.3 Arbitrazhi do të vendosë përfundimisht mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me koston.

8.4 Palët do të jenë bashkërisht përgjegjëse për pagesën e personave të specifikuar në nenin 8.1 .

Neni 9

Ndonjë lajmërim për palët palët në lidhje me arbitrazhin do të jetë me shkrim. Këto lajme do të quhet të marra sapo të arrijnë adresat e mëposhtme :

Për KfW Për AZP: NUKP
Postfach 11 1141 Pogradec, Shqipëri
60046 Frankfurt mbi Main
Gjermani
Fax: 69 74 31 29 44
Telex: 4 15 25 60 kWd
Për Huamarrësin : Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Tiranë
Fax: 355 42 284 94
Telex: 0604 5295 komplab

Hartuar në 6 origjinale,3 në gjermanisht dhe 3 në anglisht.

L I G J
Nr.8629, datë 22.6.2000

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN E
“REHABILITIMIT URGJENT TË FURNIZIMIT ME UJË” NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e Kredisë së Zhvillimit për Projektin e “Rehabilitimit urgjent të furnizimit me ujë” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2673, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

W- 1533. Doc/mfs
Departamenti Ligjor
DRAFT KONFIDENCIAL
(Subjekt për Ndryshime)
JFunashi
17, Nëntor, 1999

NUMRI I KREDISË 3322 SHQIPËRI

ZHVILLIMI I MARRËVESHJES SË KREDISË

MARRËVESHJE, e datës 18 prill 2000, midis SHQIPËRISË (huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)

NDËRSA Huamarrësi është dakord si me realizueshmërinë dhe prioritetin e Projektit të Përkthyer në Listën 2 të kësaj Marrëveshjeje, ka kërkuar nga IDA që të ndihmojë në financimin e Projektit; dhe

NDËRSA IDA ka rënë dakord, ndër të tjera, për vazhdueshmërinë e mëtejshme të Kredisë për Huamarrësin në termat dhe kushtet e paraqitura në këtë Marrëveshje.

TANI për këto ARSYE palët këtu bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Kushte të Përgjithshme : Përcaktime

Seksioni 1.01. “Kushtet e Përgjithshme të aplikueshme për Marrëveshjet e Zhvillimit të Kredisë” për IDA të datës 1 janar, 1985 (siç është rregulluar nëpërmjet Amendamenteve të datës 2 dhjetor 1997) (Kushtet e Përgjithshme), përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje:

Seksioni 1.02 Me përjashtim të rasteve kur konteksti nënkupton të kundërtën, disa terma të përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrje të kësaj Marrëveshjeje kanë domethëniet respektive të paraqitura këtu poshtë dhe termat shtesë të mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “EMP” do të thotë Plan i Menaxhimit të Mjedisit për Projektin, të pranueshme për IDA, të adoptuar nga Huamarrësi në 15 dhjetor 1999 duke siguruar për ndikimet e mjedisit dhe masave lehtësuese të propozura, të përfshira në PIP.

b) “PIP” do të thotë Plani i Zbatimit të Projektit” të datës 15 dhjetor 1999, që siguron procedurat e zbatimit për EMP, për politikat financiare dhe të llogarive për sistemin llogaritës dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe auditimit, që PIP mund të pësojë ndryshime herë pas herë sipas marrëveshjeve midis IDA dhe Huamarrësit;

c) “PIU” do të thotë njësi e Zbatimit të Projektit e ngritur nga Ministria e Punëve Publike dhe e Transporteve në 6 qershor 1994 nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.230 me qëllimin e koordinimit të përgjithshëm të zbatimit të Projektit;

d) “Paradhënia e Përgatitjes së Projektit” do të thotë paradhënia për përgatitjen e projektit e dhënë grant nga IDA për huamarrësin sipas letrës së kredisë të nënshkruar nga ana e IDA në 10 shtator 1999 dhe nga ana e Huamarrësit më 1 nëntor; dhe

e) “Llogaria e Veçante” do të thotë llogaria referuar në seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Kredia

Seksioni 2.01. IDA bie dakord t’iu japë hua Huamarrësit në termat dhe kushtet e parashtuara ose të referuara në Marrëveshjen e Zhvillimit të Kredisë një shumë në monedha të ndryshme të barabartë me shtatë milionë e treqind mijë (7.300.000 SDR) dhe në SDR (monedhë e Bankës Botërore).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me Kushtet e Listës 1 të kësaj marrëveshjeje për shpenzimet e bëra ose nëse IDA do të jetë dakord për këtë të bëhet sipas kostove të justifikueshme të mallrave dhe të shërbimeve për Projektin dhe që do të financohet jashtë procedurave të Kredisë.

b) Huamarrësi mundet, për qëllimet e Projektit, të hapë dhe të mbajë në dollarë një llogari të veçantë në një bankë të pranueshme për IDA në termat dhe kushtet e pranueshme për IDA, duke përfshirë mbrojtjen e duhur përkundrejt zhvendosjeve, konfiskimit ose bashkëngjitjes. Depozitat në dhe pagesat jashtë nga, Llogaria e Veçantë do të bëhen në përputhje me klauzolat e Listës 5 të kësaj marrëveshjeje.

c) Menjëherë mbas datës efektive IDA do të tërheqë nga llogaria e Kredisë, në emër të Huamarrësit, dhe do t’i paguajë vetes së saj shumën e kërkuar për të shlyer shumën kryesore të Paradhënies për Përgatitjen e Projektit të tërhequr dhe të papaguar që prej kësaj date dhe të paguajë të gjitha shpenzimet e papaguara për këtë qëllim. Mbetja e pa tërhequr e shumës së autorizuar për Paradhënien e Përgatitjes së Projektit që prej kësaj kohe do të eliminohet.

Seksioni 2.03. - Data e mbylljes do të jetë 1 marsi 2003 ose një ditë e tillë e mëvonshme siç do të caktohet nga IDA. IDA do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04 - (a) Huamarrësi do t’i paguajë IDA-s një tarifë angazhimi mbi shumën kryesore të Kredisë së patërhequr herë pas herë në një masë që do të caktohet nga IDA në 30 qershor të çdo viti, por që nuk do ta kalojë masën e ½ të 1% për një vit.

b) Tarifa e angazhimit do të rritet në %: i) duke kaluar 60 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (data e rritjes së %) në datat respektive në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huadhenësi nga Llogaria e

Kredisë ose do të ezaurohen; dhe (ii) në masën e tarifës së caktuar në 30 qershorin parardhës të datës së rritjes së % dhe në tarifa të tjera që do të caktohen pas kësaj datë, në përputhje me paragrafin a) të mësipërm. Tarifa e caktuar në 30 qershor të çdo viti do të aplikohet nga data e ardhshme të atij viti të specifikuar në seksionin 2.06 të kësaj marrëveshjeje.

c) Tarifa e angazhimit do të paguhet: i) në ato vende që IDA do të caktojë në mënyrë të arsyeshme; ii) pa kufizime të asnjë lloji të imponuara nga, ose në territorin e, Huamarësit; dhe iii) në monedhën e specifikuar në këtë marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme ose në një monedhë tjetër të tillë të besueshme siç mundet të vendoset ose të zgjidhet në përputhje me klauzolat e këtij Seksioni.

Seksioni 2.05. - Huamarrësi do t'i paguajë IDA-s një tarifë të shërbimit në masën e $\frac{3}{4}$ të 1% në vit mbi shumën kryesore të Kredisë së tërhequr dhe të pushlyer herë pas herë.

Seksioni 2.06. - Tarifat e zbatimit dhe të shërbimit do të paguhet në çdo gjashtë muaj në 1 shkurt dhe në 1 gusht të çdo viti.

Seksioni 2.07 – (a) Subjekt i paragrafeve b), c), d) të mëposhtëm, Huamarësi do të shlyejë shumën kryesore të Kredisë në këste gjashtë mujore të pagueshme në çdo 1 shkurt dhe 1 gusht duke filluar nga 1 gusht 2010 dhe përfunduar në 1 shkurt 2040. Çdo kësht dhe duke përfshirë kështet e pagueshme në 1 shkurt 2020 do të jetë 1% i kësaj shume kryesore dhe që këtë e tutje çdo kësht do të jetë 2% i kësaj shume kryesore.

b) Sa herë që: i) prodhimi kombëtar për një ri (GNP), siç është vendosur nga IDA të tejkalojë për tre vjet të një pasnjëshëm nivelin e vendosur për çdo vit nga IDA për të vendosur mbi besueshmërinë për të shlyer borxhin e IDA; dhe ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të besueshëm për të marrë borxh, IDA mundet, pas rishikimit dhe aprovimit nga drejtuesit Ekzekutivë dhe pas marrjes në mënyrë të duhur në konsideratë prej tyre të zhvillimit të ekonomisë së Huamarësit, të modifikojë shlyerjen nëpërmjet kësteve në Paragrafin a) të mësipërm si me poshtë:

(A) duke i kërkuar Huamarësit të shlyejë dy herë shumën e çdo kështi të papaguar ende derisa të jetë shlyer plotësisht kredia; dhe

(B) duke i kërkuar huamarrësit të fillojë pagimin e shumës kryesore sipas kështit të parë gjashtëmujor të referuar në paragrafin a) të mësipërm gjashtë muaj ose më shumë mbas datës në të cilën IDA njofton Huamarrësin që një nga fenomenet e përmendura në paragrafin b) të ketë ndodhur, me kushtin që, sidoqoftë, do të jetë një periudhë favorizuese (pa detyrime penaliteti) për të paktën 5 vjet në këtë shlyerje të borxhit kryesor.

c) Nëse kjo do të kërkohej nga Huamarësit, IDA mund të rishikojë modifikimet e referuara në paragrafin b) të mësipërm për të përfshirë, në vend të disa ose të gjitha rritjeve në shumën e kësteve të tilla, pagesën e interesit sipas një tarife vjetore të rënë dakord me IDA mbi shumën kryesore të Kredisë së tërhequr dhe të pushlyer herë pas herë, me kushtin që, sipas gjykimit të IDA, një rishikim i tillë nuk do të ndryshojë elementin e grantit të përfutur nën modifikimin e shlyerjes së sipërpërmendur.

d) Në qoftë se ndonjëherë pas modifikimit të termave sipas paragrafit b) të mësipërm IDA vendos që kushtet ekonomike të Huamarësit kanë rënë në mënyrë të dukshme, IDA mundet, nëse kjo kërkohej nga Huamarësi, të modifikojë më tej termat e shlyerjes së borxhit konform listës së kësteve siç kushtezohet në paragrafin a) të mësipërm.

Seksioni 2.08. - Monedha e USA është këtu më poshtë e specifikuar për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 3 Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01. - a) Huamarësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit siç është parashtruar në Listën 2 të kësaj marrëveshjeje, dhe, në përfundim do të zbatojë projektin nëpërmjet PIU me kujdesin dhe efikasitetin e duhur konform praktikave të duhura administrative, financiare, inxhinierike, të ambientit dhe teknike dhe duhet të sigurojë, ashtu siç duhet, fondet, pajisjet, shërbimet dhe të tjera

burime të kërkuara për Projektin.

b) - Pa kufizim mbi kushtet e paragrafit a) të këtij seksioni dhe vetëm nëse IDA dhe Huamarrësi do të bien dakord për të kundërtën, Huamarrësi do të kryejë Projektin në përputhje me Programin e Zbatimit të parashtruar në Listën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02.- Përveç rastit kur IDA do të jetë dakord për të kundërtën, prokurim i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulencës të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen jashtë të ardhurave të Kredisë, do të udhëhiqet nga klauzolat e Listës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03.- Për qëllimet e Seksionit 9.07 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa kufizime për këto, Huamarrësi do të:

a) përgatisë në bazë të udhëzuesve të pranueshme për IDA, dhe t'i japë IDA jo më vonë se 6 muaj mbas ditës së mbylljes ose një ditë tjetër të mëvonshme siç mund të jetë rënë dakord për këtë qëllim midis Huamarrësit dhe IDA, një plan për veprimtarinë e ardhshme të projektit; dhe

b) t'i japë rastin IDA-s të shkëmbjë pikëpamje me Huamarrësin për planin e sipërtreguar.

Neni 4

Aktet Financiare

Seksioni 4.01- a) Huamarrësi do të krijojë PIU për vendosjen dhe ruajtjen e një sistemi financiar menaxhimi, duke përfshirë regjistrat dhe llogaritë, dhe të përgatisë marrëveshjet financiare në një format të pranueshëm për IDA, adekuat për të reflektuar operacionet, burimet dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me Projektin.

b) - Huamarrësi do të detyrojë PIU që :

i) - të këtë regjistrat, llogaritë dhe gjendjet financiare që i referohen paragrafit a) të këtij Seksioni dhe regjistrat dhe llogaritë për Llogarinë e Veçantë për secilin vit fiskal të audituar, në përputhje me standardet e auditimit të pranueshme për IDA, të zbatuar në mënyrë konsistente, nga kontrollues independentë të pranueshëm për IDA;

i) t'i japë IDA sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të çdo viti të tillë, (A) kopje të certifikuara të gjendjeve financiare të referuara në paragrafin (a) të këtij Seksioni për këtë vit siç është audituar, dhe (B) një opinion mbi këto gjendje, regjistra llogari dhe raporte të këtyre kontrolleve, nga kontrollorët e sipërtreguar, në fushat dhe detaje të tilla siç do të këtë kërkuar IDA në mënyrë të arsyeshme; dhe

ii) të pajisë IDA informacione të tjera të nevojshme në lidhje me këto regjistra dhe llogari, dhe kontrollat e tyre, dhe në lidhje me kontrollorët e mësipërm, siç mund të kërkojë IDA herë pas herë në mënyrë të arsyeshme.

b) Për të gjitha harxhimet në lidhje me tërheqjet nga Llogaria e Kredisë që janë bërë në bazë të deklaratave të shpenzimeve, Huamarrësi do :

i) të mbajë ose të urdhërojë që të mbahen, në përputhje me paragrafin a) të këtij Seksioni, regjistra dhe llogari të veçanta që reflektojnë këto shpenzime;

ii) të ruajë deri të paktën një vit pasi IDA të këtë marrë Raportin e auditimit për vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e fundit nga Llogaria e Kredisë, të gjitha regjistrat (kontratat, porositë, faturat, fletë-marrjet, dhe dokumentet e tjera) që evidentojnë këto shpenzime;

iii) të mundësojë përfaqësuesit e IDA të ekzaminojnë këto regjistra; dhe

iv) të sigurojnë që këto regjistra janë të përfshirë në kontrollin vjetor të referuar në paragrafin b) të këtij Seksioni dhe që raporti i këtij auditimi përmban një opinion të veçantë nga kontrollorët e sipërpërmendur, duke treguar nëse deklaratat e shpenzimeve të paraqitura gjatë këtij viti fiskal, së bashku me procedurat dhe kontrollat e brendshme të përfshira në përgatitjen e tyre, mund të jenë të besueshme për të mbështetur tërheqjet përkatëse.

Seksioni 4.02 – (a) Pa kufizim mbi klauzolat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të zbatojë një plan veprimi me kohë të përcaktuar të pranueshëm për IDA për fuqizimin e sistemit të menaxhimit financiar referuar në paragrafin a) Seksionit 4.01 me qëllim që të bëjë të mundur që Huamarrësi, jo më vonë se sa 31 gushti 2000, ose një datë tjetër të mëvonshme siç do të bjerë dakord

IDA, të përgatisë Raporte të Menaxhimit të Projektit, të pranueshme për IDA, secila prej të cilave:

i) (A) parashtron burimet aktuale dhe aplikimet e fondeve për Projektin, së bashku në mënyrë progresive dhe për periudhën e mbuluar nga raporti i sipërpërmendur, dhe burimet e Projektit dhe aplikimet e fondeve për Projektin për gjashtëmujorin në vazhdim të periudhës së mbuluar nga raporti dhe (B) tregon në mënyrë veç e veç harxhimet e financuara jashtë të ardhurave të kredisë gjatë periudhës gjashtëmujore në vazhdim të periudhës së mbuluar nga ky raport dhe shpenzimet e propozuara që do të financohen jashtë të ardhurave të kredisë gjatë periudhës gjashtë mujore në vazhdim të periudhës së mbuluar në raport.

ii) (A) të përshkruajë progresin fizik në zbatimin e Projektit, së bashku në mënyrë progresive dhe për periudhën e mbuluar nga ky raport, dhe (B) shpjegon ndryshimet midis rezultateve të arritura aktualisht dhe parashikimeve për objektivat e caktuara; dhe

iii) të parashtojë statusin e prokurimit të Projektit dhe të shpenzimeve nën Kontratat e financuara jashtë të ardhurave të kredisë në fund të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Me kompletimin e planit të veprimit të referuar në paragrafin a) të këtij Seksioni, Huamarrësi do të përgatisë, në përputhje me udhëzuesit e pranueshëm për IDA, dhe të pajisë IDA jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të secilit tre-mujor një Raport të Menaxhimit të Projektit për këtë periudhë.

Neni 5

Përfundimi

Seksioni 5.01. 90 ditë pas datës së specifikuar në këtë marrëveshje për qëllimet e seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 6

Përfaqësuesi i Huamarrësit: Adresat

Seksioni 6.01. Ministri i Financës së Huamarrësit caktohet si përfaqësues për qëllimet e Seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 6.02 Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

Për Huamarrësin: Për IDA

Ministria e Financave Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA)

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" 1818 H Street, N.W.

Tiranë Washington D.C. 20433

Shqipëria Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Telex 4295 Komplan AB

Adresa telefonike

248423 (MCI)

64.145 (MCI)

INDEVAS

Washington D.C.

Në PRANI të TYRE, palët si me poshtë, duke vepruar me përfaqësuesit e tyre të autorizuar, ashtu siç duhet, kanë bërë të nënshkruhet kjo Marrëveshje në emrat e tyre respektive në Distriktin e Kolumbisë< USA, në ditën dhe vitin e sipërshënuar.

SHQIPËRI

Nga Përfaqësuesi i Autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIMIN

Nga Nën President Rajonal

Për Europën dhe Azinë Qendrore

LISTA 1
TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË KREDISË

Tabela e mëposhtme parashtron Kategoritë e artikujve që do të financohen jashtë të ardhurave të projektit, alokimin e shumave të Kredisë të secilës Kategori dhe % e shpenzimeve për artikujt që do të financohen në secilën Kategori.

Kategoria	Shuma e Kredisë të alokuar (të shprehur në USD)	% e shpenzimeve që do të financohen
Punime Rehabilitimi Riparimi dhe fuqizimi operacional	5,140,000 180.000	85%
Mallrat	500.000	100% të shpenzimeve nga jashtë vendit, 100% e shpenzimeve lokale (kostoja jashtë- fabrikave) dhe 85% e shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar lokalisht
3) Shërbimet e Konsu- lencës	1.320.000	100%
4) Kosto operative në rritje	80.000	80%
5) Rifinancimi i Para- dhënies së Përgatitjes së Projektit	500.000	Shumat e duhura sipas Seksionit 2.02 (c) të kësaj Marrëveshjeje
6) të paalokuara	2.280.000	
Totali	10.000.000	

2. Për qëllimet e kësaj Liste:

a) termi “ shpenzime të jashtme” do të thotë shpenzime në monedhën e ndonjë vendi tjetër të ndryshëm nga ai i vendit të Huamarrësit për mallrat ose shërbimet të furnizuara nga territori i ndonjë vendi tjetër, të ndryshëm nga ai i Huamarrësit;

b) termi “shpenzime lokale” do të thotë harxhime të bëra në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat ose shërbimet të furnizuara nga vendi i Huamarrësit; dhe

c) termi “ kosto operationale në rritje” do të thotë shpenzime në rritje të shkaktuara nga PIU për llogari të zbatimit të Projektit, menaxhimit dhe monitorimit, duke përfshirë furnizimet për zyrën, përdorimin e makinave, udhëtimet, qeranë, komunikimet dhe rrogat për staf shtesë, duke përfshirë ato për shërbyes civil, të shkaktuara për qëllimin e zbatimit të projektit mbas 1 janarit 2000.

1. Pavarësisht nga klauzolat e paragrafit 1 të mësipërm asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me:

a) Pagesat e bëra për harxhimet përpara datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) pagesat e bëra për harxhimet nën Kategorinë (1) për punimet e rehabilitimit, në qoftë se kontrata për operatorin privat nuk do të paraqitet deri në 31 dhjetor të vitit 2000.

2. IDA mund të kërkojë tërheqje nga Llogaria e Kredisë që të bëhet në bazë të deklaratës së shpenzimeve nën kontrat (i) për punime civile që kushtojnë më pak se 100.000 \$; (ii) për mallra që kushtojnë më pak se 100.000\$; (iii) për shërbime konsulence për firma që kushtojnë më pak se 100.000\$; (iv) për shërbime konsulence për individë që kushtojnë më pak se 50.000\$; dhe (v) për kosto operationale

në rritje nën terma dhe kushte të tilla siç do të specifikojë IDA duke njoftuar Huamarrësin.

LISTA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti i këtij Projekti është që të rehabilitojë mbi baza emergjence sistemin e furnizimit me ujë për qytetet e Durrësit, Fierit, Lezhës, dhe Sarandës të vendit të Huamarrësit.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme, subjekt i modifikimeve të tilla siç mund të vendosin IDA dhe Huamarrësi herë pas herë për të arritur objektivat e caktuar.

Pjesa A: Rehabilitimi i Furnizimit me ujë

Përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së furnizimit me ujë nëpërmjet:

- a) furnizimi dhe instalimi i klorinatorëve;
- b) furnizimi i tubave, pjesëve speciale, materialeve, pjesëve të këmbimit dhe kontratat për riparimet kritike në vend të humbjeve të dukshme në rrjetin shpërndarës;
- c) riparimi dhe zëvendësimi i tubave, rezervuarave të depozitimit, stacioneve të pompimit, dhe puseve për të rritur sasinë e ujit të dërguar;
- d) ngritja e puseve të rinj për Rrethin e Durrësit;
- e) sigurimi i asistencës teknike për të identifikuar defektet operacionale dhe të bëjë rekomandimet;
- f) sigurimi i asistencës teknike për të përcaktuar mënyrën e duhur për pagimin e tarifave për ujin dhe mekanizmin e zvogëlimit të shpërdorimit të ujit nëpër fshatra. Dhe
- g) kryerja e një studimi bëshmërie për furnizimin me ujë në fshatrat pranë tubacionit kryesor të furnizimit me ujë për Durrësin.

Pjesa B: Menaxhim i Projektit

1. Fuqizimi i kapacitetit menaxhues të PIU për të monitoruar dhe administruar zbatimin e Projektit nëpërmjet sigurimit të asistencës teknike trajnimit dhe kostove operacionale; dhe

2. sigurimi i asistencës teknike për të kryer auditimin e Projektit.

Projekti përfundohet që të përfundojë nga 30 shtatori 2002.

LISTA 3 PROKURIMI DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni 1. Prokurimi i mallrave dhe i punimeve

Pjesa A të përgjithshme

Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me (a) klauzolat e Seksionit I të “Udhëzuesit për Prokurimet nën huat e IBRD dhe Kredive të IDA” të publikuar nga Banka në janar 1995 dhe të rishikuar në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999, subjekt i modifikimeve të parashtruara në paragrafin 2 të kësaj pjesë A (Udhëzuesit), dhe (b) klauzolat e pjesëve në vazhdim të këtij Seksioni I.

Pjesa B. Tenderi Internacional

1. Përveçse si është përcaktuar ndryshe nga kushtet e parashtruara në Pjesën C të këtij seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen nën kontratat e paraqitura në përputhje me klauzolat e Seksionit II të Udhëzuesit dhe paragrafit 5 të Apendiksit 1 këtu pranë.

2. Klauzolat e mëposhtme do të zbatohen për punimet nën kontratat e dhëna në përputhje me klauzolat e paragrafit 1 të kësaj Pjesë B

Prekualifikimi

Pjesëmarrësit në Tender për punimet civile do të prekualifikohen në përputhje me klauzolat e paragrafëve 2.9 dhe 2.10 të Udhëzuesve.

Pjesa C: Te tjera Procedura të Prokurimit

1. Tenderi Lokal

Punimet që vlerësohen të kushtojnë më pak se 500.000 \$ për kontratat, deri në një shumë të përgjithshme që nuk i kalon 700.000 \$ mund të prokurohen nën kontratat e parashtruara në përputhje me

klauzolat e paragrafit 3.3 dhe 3.4 të Udhëzuesve.

2. Blerjet ndërkombëtare

Mallrat që llogariten të kushtojnë më pak së 100.000 \$ për kontratë, deri në një shumë të Përgjithshme që nuk i tejkalon 475 \$ ekuivalent mund të prokurohen nën kontratat e paraqitura në bazë të procedurave të blerjeve internacionale në përputhje me klauzolat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzuesve.

3. Blerjet lokale

Mallrat që vlerësohen të kushtojnë më pak së 30.000 \$ për kontratë, deri në një shumë të përgjithshme që nuk e tejkalon 50.000\$ mund të prokurohen nën kontratat e paraqitura mbi bazë të procedurave të blerjeve kombëtare në përputhje me klauzolat e paragrafëve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzuesve.

4. Prokurimi i Punimeve të Vogla

Punimet e vlerësuara të kushtojnë më pak së 100.000\$ për kontratë me një shumë të përgjithshme që nuk kalon 325.000\$, mund të prokurohen me shuma të përcaktuara kontrata me çmime fikse të paraqitura në bazë të kuotimit të përfutur nga 3 kontraktues të kualifikuar vendas në përgjigje të një ftese për ofertë të shkruar. Ftesa do të përfshijë një përshkrim të detajuar të punimeve, duke përfshirë specifikat bazë, datën e kërkuar të përfundimit, një formë bazë të marrëveshjes së pranueshme për IDA, dhe vizatimet përkatëse ku është e aplikueshme. Dhënia e Tenderit do t'i bëhet kontraktuesit që ofron çmimin me të ulët të kontratës për punimet e kërkuara, dhe që ka eksperiencën dhe burimet për të përfunduar me sukses kontratën.

Pjesa D Rishikimi nga ana e IDA për Vendimet e Prokurimit

Planifikimi i prokurimit

Përpara së të dalë ndonjë nga ftesat për prekualifikim për pjesëmarrësit në Tender ose për të konkuruar për kontratat, plani i propozuar i prokurimit për projektin do t'i paraqitet IDA për rishikimin dhe aprovimin e saj, në përputhje me kushtet e paragrafit 1 të Apendiksit 1 të Udhëzuesit. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të ndërmerret në përputhje me një plan prokurimi të tillë siç do të jetë aprovuar nga IDA, dhe me kushtet e paragrafit 1 të sipërpërmendur.

2. Rishikimi paraprak

a) Në lidhje me çdo kontratë për paragrafin 1 të Pjesës B të vlerësuar të kushtojë 500.000 \$ për punimet, çdo kontratë për paragrafin 1 të pjesës B të vlerësuar të kushtojë 100.000\$ për mallrat , do të aplikohen procedurat e paraqitura në paragrafet 2 dhe 3 të Apendiksit 1 të Udhëzuesve.

b) Në lidhje me tre kontratat e para në secilin qytet për paragrafet 1,2,3 dhe 4 të pjesës C, do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

(i) Përpara seleksionimit të ndonjë shitësi nën procedurata e blerjes, Huamarrësi do t'i paraqesë IDA një raport mbi krahasimet dhe vlerësimet e kuotimeve të marra;

(ii) përpara ekzekutimit të ndonjë kontrate të preokuruar në procedurat e blerjes, huamarrësi do të sigurojë për IDA një kopje të karakteristikave dhe një kontratë draft; dhe

(iii) do të aplikohen procedurat e paraqitura në paragrafet 2(f), 2(g) dhe 3 të Apendiksit 1 të Udhëzuesit.

Rishikimi më pas

Për çdo kontratë që nuk mbulohet nga paragrafi 2 i kësaj pjese, do të aplikohen procedurat e parashtruar në paragrafin 4 të Apendiksit 1 të Udhëzuesit.

Seksioni II. Punësimi i konsulentëve

Pjesa A të përgjithshme

1. Shërbimet e konsulencës do të prokurohen në përputhje me (a) klauzolat e kapitujve të Parathënies dhe Seksionit IV të “Udhëzuesit: Seleksionimi dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës” të publikuar nga IDA në janar 1997 dhe të rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999 (Udhëzuesit e Konsulentit); dhe (b) kushtet e klauzolave të mëposhtme të këtij Seksioni II.

Pjesa B: Seleksionimi në bazë të Kostos dhe të Cilësisë

1. Përveçse siç është përcaktuar ndryshe në Pjesën C të këtij Seksioni, shërbimet e konsulencës do të prokurohen nën kontratat e paraqitura në përputhje me klauzolat e Seksionit II të Udhëzuesit për Konsulencën, paragrafi 3 i Apendiksit 1, dhe Apendiksit 2 këtu, si dhe klauzolave të paragrafit 3.13 deri në 3.18 të cilat janë të aplikueshme për përzgjedhjen e konsulentëve në bazë të cilësisë dhe sasisë.

2. Klauzolat e mëposhtme do të aplikohen për shërbimet e konsulentit që do të prokurohen nën kontratat e paraqitura në përputhje me klauzolat e paragrafeve të mëparshme. Short List e konsulentëve për shërbimet e Menaxhimit të Projektit nën Pjesën B të Projektit, të vlerësuara të kushtojë më pak se 100.000\$ për kontratë, mund të përfshijnë edhe konsulentë plotësisht lokalë në përputhje me klauzolat e paragrafit 2.7 të Udhëzuesve për Konsulentët.

Pjesa C: të tjera procedura për seleksionimin e Konsulentëve

1. Seleksionimi sipas Kostos më të Ulët

Shërbimet për Menaxhimin e Projektit nën Pjesën B (2) të Listës 2 të vlerësuara të kushtojnë më pak se 30.000 \$ për kontratë mund të prokurohen nën kontratat e paraqitura në përputhje me kushtet e paragrafit 3.1 dhe 3.6 të Udhëzuesit për Konsulentët

2. Konsulentët Individualë

Shërbimet për Menaxhimin e Projektit nën Pjesën B (1) të Listës 2 mund të prokurohen në përputhje me klauzolat e paragrafit 5.1 deri 5.3 të Udhëzuesit për Konsulentin.

Pjesa D: Rishikimi nga IDA i Seleksionimit të Konsulentëve

Planifikimi i Seleksionimit

Përpara paraqitjes të konsulentëve të ndonjë kërkesë për propozimet, plani i propozuar për seleksionimin e konsulentëve do t'i paraqitet IDA për rishikimin dhe aprovimin e saj, në përputhje me klauzolat e paragrafit 1 të Apendiksit 1 të Udhëzuesve për Konsulentin. Seleksionimi i të gjithë shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me një plan të tillë seleksionimi siç është aprovuar nga IDA dhe me klauzolat e paragrafit 1 të sipërtreguar.

Rishikimi paraprak

a) Për çdo kontratë për punësimin e firmave konsulente për paragrafin 1 të Pjesës B, do të aplikohen procedurat e paraqitura në paragrafet 1, 2 (përveç në paragrafin 3 të paragrafit 2 (a) dhe 5 të Apendiksit 1 të Udhëzuesit për Konsulentin.

b) Për çdo kontratë për punësimin e konsulentëve individualë për paragrafin 1 dhe 2 të Pjesës C, kualifikimet, eksperiencat, termat e references dhe termat e punësimit do t'i paraqiten IDA për rishikimin dhe aprovimin e saj paraprak. Kontrata do të jepet vetëm pasi të jetë marrë aprovim i sipërtreguar.

Rishikimi i mëvonshëm

Për çdo kontratë që nuk bën pjesë në paragrafin 2 të kësaj Pjesë, do të aplikohen procedurat e paraqitura në paragrafin 4 të Apendiksit 1 të Udhëzuesit për Konsulentin.

LISTA 4 PROGRAMI I IMPLEMENTIMIT

1. Huamarrësi do të ruajë deri në përfundim të Projektit, PIU, me burimet, stafin dhe termat e referencës që plotësojnë kërkesat e IDA dhe do t'i caktojë asaj përgjegjësinë për zbatimin dhe koordinimin e përgjithshëm të Projektit, duke përfshirë:

a) përgatitjen e Dokumenteve të Tenderit dhe administrimin e procedurave të tenderit dhe të kontratave nën Projektin;

b) përgatitjen e aplikimeve të disbursimeve nën Kreditë

c) menaxhimin e Llogarisë Speciale të referuar në Listën 1 të Marrëveshjes së Kredisë;

d) mbajtjen e regjistrave dhe llogarive në lidhje me Projektin dhe mundësimin e auditimit për to; dhe

e) përgatitjen e raporteve progresive tremujore dhe paraqitjen e tyre jo më vonë se 30 ditë pas mbarimit të tremujorit, për Huamarrësin dhe IDA.

2. Huamarrësi do të: (a) sigurojë që të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e EMP dhe PIP të merren në kohën e duhur; dhe (b) të përfshijë informacion të përshtatshëm mbi zbatimin e masave të tilla në raportet progresive të referuara në paragrafin 1(e) të kësaj Liste.

3. Huamarrësi do të:

a) ruajë një politikë dhe procedura adekuate që t'i bëjnë të mundur atij të monitorojë dhe vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Projektit dhe arritjen e objektivave;

b) përgatisë nën terma reference të kënaqshme për IDA, dhe të pajisë IDA në, ose rreth datës 31 janar 2002 me raporte të përgjithshme duke përfshirë të gjitha rezultatet e veprimeve monitoruese dhe vlerësuese të kryera në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, mbi progresin e arritur në periudhën përpara datës së këtij raporti, dhe të përcaktojë masat e nevojshme të rekomanduara për të siguruar zbatimin me efikasitet të Projektit dhe arritjen e objektivave të caktuara për periudhën në vazhdim; dhe

c) rishikimi me IDA, nga data 15 mars 2000 ose në një datë të tillë të mëvonshme siç mund të kërkohej nga IDA, të raporteve të referuar në paragrafin (b) të këtij seksioni, dhe pas kësaj, të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar përfundimin me efikasitet të Projektit dhe arritjen e objektivave të caktuara, të bazuar në konkluzionet dhe të rekomandimet e këtij raporti dhe të pikëpamjeve të IDA për këtë çështje.

LISTA 5 LLOGARIA SPECIALE

1. Për qëllimet e kësaj Liste:

a) termi “kategori të përshtatshme” do të thotë Kategoritë 1, 2, 3 dhe 4 të paraqitura në tabelën e paragrafit 1 të Listës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

b) termi “shpenzime të pranueshme” do të thotë shpenzime me kosto të arsyeshme për mallrat dhe shërbime të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen jashtë të ardhurave të Kredisë të Alokua herë pas herë për kategori të përshtatshme në përputhje me klauzolat e Listës 1 të kësaj marrëveshjeje; dhe

c) termi “Alokimi i Autorizuar” do të thotë një shumë e barabartë me 600.000\$ që do të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitohet në Llogarinë speciale sipas paragrafit 3.a) të kësaj Listë, me kushtin që sidoqoftë, kur IDA nuk ka kundërshtim, Alokimi i Autorizuar të kufizohet deri në 300.000\$ derisa shuma e përgjithshme e tërheqjeve nga Llogaria e Kredisë + shumën e përgjithshme të të gjithë operacioneve të veçanta sipas Seksionit 5.02 të Kushteve të Përgjithshme do të jetë e barabartë ose të kalojë 2 milionë SDR.

2. Pagesat jashtë llogarisë speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme në përputhje me klauzolat e kësaj Liste.

3. Pasi IDA të këtë marrë njoftime të kënaqshme që Llogaria speciale është hapur siç duhet, tërheqjet e Autorizimeve të Alokua dhe tërheqjet shtesë për të rimbushur Llogarinë speciale do të bëhen si me poshtë:

a) Për tërheqjen e Alokimeve të Autorizuara, Huamarrësi do t'i paraqesë IDA-s një kërkesë ose kërkesa për të depozituar në Llogarinë speciale një shumë ose shuma që nuk e kalojnë shumën e përgjithshme të Alokimit të Autorizuar. Në bazë të një kërkesë ose kërkesave të tilla, IDA do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë për palën e Huamarrësit dhe të depozitojë në Llogarinë Speciale një shumë ose shuma të tilla siç ka kërkuar Huamarrësi.

b) (i) Për rimbushjen e Llogarisë speciale, Huamarrësi do t'i paraqesë IDA kërkesat për depozitime në Llogarinë Speciale në intervale të tilla siç do të specifikojë IDA.

(ii) Përpara se, ose në kohën e çdo kërkesë të tillë, Huamarrësi do të paraqesë IDA-s dokumentet dhe të tjera evidenca të kërkuara në përputhje me paragrafin 4 të kësaj Listë për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat është kërkuar rimbushje. Në bazë të çdo kërkesë të tillë, IDA do të tërheqë, për palën e Huamarrësit nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë Speciale shuma të tilla siç ka kërkuar Huamarrësi dhe siç janë treguar në dokumentet dhe evidencat e tjera të sipërtreguara, që të jenë paguar jashtë Llogarisë Speciale për shpenzime të pranueshme. Të gjitha këto depozita do të tërhiqen nga Llogaria e Kredisë nën Kategoritë respektive të përshtatshme, dhe në shumat respektive ekuivalente, siç është justifikuar nga dokumentet e sipërtreguara dhe evidenca të tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi jashtë Llogarisë Speciale, Huamarrësi do të pajisë IDA, në kohën kur kjo do ta quajë të arsyeshme, me dokumente dhe evidenca të tjera që tregojnë që këto pagesa janë bërë ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme.

5. Pavarësisht nga klauzolat e paragrafit 3 të kësaj Liste, nga IDA nuk do të kërkohej të bëjë depozitime të mëtejshme në Llogarinë Speciale kur:

a) në qoftë se, në ndonjë kohë, IDA do të këtë vendosur, që të gjitha tërheqjet e ardhshme duhet të bëhen nga Huamarrësi drejtpërdrejt nga Llogaria e Kredisë në përputhje me Klauzolat e Artikullit 5 të Kushteve të Përgjithshme dhe paragrafin a) të Seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

b) në qoftë se Huamarrësi do të këtë dështuar në pajisjen e IDA, brenda afateve të përcaktuara në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, me raporte auditimi të çdo lloji, që janë kërkuar nga IDA sipas Seksionit të sipërtreguar në lidhje me auditimin e regjistrave dhe të llogarive të Llogarisë Speciale;

c) në qoftë se, ndonjë herë IDA do të këtë njoftuar Huamarrësin për qëllimet e saj për të pezulluar pjesërisht ose tërësisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kredisë në përputhje me klauzolat e Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme ; ose

d) menjëherë sapo shuma totale e tërhequr e Kredisë së alokuar për kategoritë e pranueshme minus shumën totale të të gjitha veprimeve e veçanta të ndërmarra nga IDA në përputhje me Seksionin 5.02 të Kushteve të Përgjithshme të Projektit, do të barazojnë dy fishin e shumës së Alokimit të Autorizuar.

6. Pas kësaj, tërheqjet nga Llogaria e Kredisë të shumës së mbetur pa u tërhequr të Kredisë së alokuar për kategoritë e përshtatshme do të ndjekin procedura të tilla siç do të specifikohen nga IDA në njoftimet e saj për Huamarrësin. Këto tërheqje të mëvonshme do të bëhen vetëm mbasi, dhe me kushtin që IDA të jetë e kënaqur që të gjitha këto shuma që janë të depozituara në Llogarinë Speciale që nga data e këtij njoftimi të përdoren për kryerjen e pagesave të harxhimeve të pranueshme.

a) Në qoftë se IDA do të vendosë ndonjëherë për çfarëdolloj pagese jashtë Llogarisë Speciale që ajo: (i) është bërë për një harxhim ose në një shumë jo të pranueshme sipas paragrafit 2 të kësaj Liste; ose (ii) nuk është justifikuar nga evidencat e paraqitura për IDA, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të IDA do të: (A) sigurojë evidenca të tilla shtesë siç mund të kërkojnë nga IDA; ose (B) do të depozitojë në Llogarinë Speciale (ose, në qoftë se do të kërkojnë nga IDA, t'i rimbursojë IDA-s) një shumë të barabartë me shumën e kësaj pagese ose vetëm pjesën e kësaj shume të pajustificuar. Vetëm nëse IDA do të bjerë dakord për të kundërtën, asnjë depozitim i mëtejshëm nuk do të bëhet nga IDA për Llogarinë Speciale derisa Huamarrësi të ketë siguruar evidencat e kërkuara ose të ketë bërë depozitim ose rimbursimin e shumave, sipas rastit.

b) Nëse IDA do të vendosë ndonjëherë që ndonjë shume e papaguar në Llogarinë Speciale nuk do të kërkojnë për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzime të përshtatshme, Huamarrësi menjëherë pas njoftimit të IDA do të rimbursojë për IDA-n këtë shumë të papaguar.

c) Huamarrësi mundet, me njoftimin e IDA, të rimbursojë për IDA të gjithë ose një pjesë të fondeve të depozituara në Llogarinë Speciale.

d) Rimbursimet për IDA të bërë sipas paragrafëve 6 (a), (b), (c) të kësaj Liste do të kreditohen në Llogarinë e Kredisë për tërheqje të mëtejshme ose për anulim në përputhje me klauzolat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë Kushtet e Përgjithshme.

V E N D I M

Nr.443, datë 1.6.2000

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

- I. Zoti Apostol Noti zgjidhet në detyrën e anëtarit të KKRT-së, në vend të zonjës Pranvera Strakosha, e cila ka dhënë dorëheqjen.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

D E K R E T
Nr.2678, datë 06.07.2000

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenti 136, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 4, të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, me pëlqim të Kuvendit

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Perikli Zaharia (Polloshi) emërohet anëtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.334, datë 23.6.2000

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË KONTROLLIT TË DEKLARIMIT TË PASURIVE TË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 10, të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 “Për deklarimin e pasurive të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve të Shërbimit Publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e komisionit për kontrollin e deklarimit të pasurisë së personelit të administratës doganore, me përfaqësues nga:
1. Këshilli i Ministravekryetar
 2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeveanëtar
 3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeveanëtar
 4. Drejtoria e Kontrollit Administrativ, në Këshillin e Ministraveanëtar

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganaveanëtar

6. Ministria e Drejtësisëanëtar

7. Ministria e Financaveanëtar

2. Kryetari dhe anëtarët e komisionit caktohen për një periudhë 1-vjeçare.

3. Brenda 15 ditëve nga dalja e këtij vendimi, institucionet e mësipërme të dërgojnë, pranë Këshillit të Ministrave, emrat e anëtarëve.

4. Pranë komisionit ftohen të marrin pjesë, si vëzhgues, një përfaqësues i Misionit të Organizatës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit Europian në Shqipëri, dhe të Misionit të Asistencës Doganore, të Komisionit Europian.

5. Detyrat e këtij komisioni janë:

Verifikimi sistematik i deklarave të pasurive të personelit të administratës doganore, sipas një grafiku të hartuar nga kryetari i komisionit dhe i miratuar nga komisioni. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e tatimeve në rrethe janë të detyruara t'i japin komisionit, sa herë që ai ua kërkon, të gjitha deklaratat e dosjeve personale të secilit punonjës.

Për verifikimin e deklarimeve për pasuritë, komisioni ka të drejtë të shfrytëzojë dokumentacionin e arkivit të tatimpaguesve, të hipotekës, të kadastrës, bankave, Komisionit të kthimit të Pronave, zyrave të noterisë, AKP-së, etj, ku është e regjistruar çdo pasuri të deklaruar, sipas ligjit nr.7903, datë 8.3.1995, "Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të Shërbimit Publik".

Ruan sekretin për të dhënat që merr nga institucionet dhe zyrat e lartpërmendura.

Ruan konfidencialitetin e deklarimeve të bëra nga nëpunësit.

Brenda vitit 2000 komisioni do të kontrollojë deklaratat e vitit 1999.

Kontrollon, sipas rastit, deklaratat e pasurive të dorëzuara që nga viti 1996 e në vazhdim.

Pasqyron, me dokumentacion të veçantë, të gjithë veprimtarinë kontorlluese që kryen.

Bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për t'u njohur me rastet e përfshirjes në korrupsion, të cilat janë vënë re nga nëpunësit e kësaj drejtorie, dhe masat e marra.

Për kundërvajtjet administrative, u propozon organeve përgjegjëse zbatimin e dënimeve që parashikojnë nenet 8 dhe 9, të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995.

Njofton, me shkrim, çdo 3 muaj Kryeministrin, ministrin e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për kontrollat e ushtruara dhe rezultatet e dala gjatë kontrollit.

Bën sugjerimet e nevojshme për ndryshimin e ligjit nr.7903, datë 8.3.1995.

6. Kryetari dhe anëtarët e komisionit, paguhet për orët shtesë, jashtë kohës së orarit zyrtar, në masën që përcakton vendimi nr.761, datë 19.11.1998, i Këshillit të Ministrave, "Për kohën e punës dhe të pushimit në Shërbimin Civil".

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga dhënia e shpërblimit të komisionit, përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

V E N D I M

Nr.335, datë 23.6.2000

PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të pikës 2/a të nenit 8, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punëve Publike dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Enti prokurues të përdorë “Tenderin e hapur”, në përputhje me nenin 23, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, kur vlera e përllogaritur e kontratës është mbi 5 (pesë) milionë lekë për prokurimin e ndërtimeve, mbi 3 (tre) milionë lekë për prokurimin e mallrave dhe mbi 1 (një) milion lekë për prokurimin e shërbimeve, me përjashtim të projekteve.

2. Enti prokurues të përdorë “Tenderin e kufizuar”, në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 18, dhe nenin 36 të ligjit të sipërpërmendur, kur vlera e përllogaritur e kontratës nuk është më e madhe se 5 (pesë) milionë lekë për prokurimin e ndërtimeve, 3 (tre) milionë lekë për prokurimin e mallrave dhe jo më e madhe se 1 (një) milionë lekë për prokurimin e shërbimeve, me përjashtim të projekteve, ku si referim do të merret vlera e parashikuar për sipërmarrjen e ndërtimit të objektit dhe jo ajo e shërbimit.

Në këtë rast enti prokurues do të sigurojë oferta nga jo më pak se 3 (tre) kandidatë. Për tenderin ndërkombëtar, enti prokurues do të sigurojë të paktën 3 (tre) oferta, nga jo më pak se 3 (tre) shtete të ndryshme.

3. Enti prokurues të përdorë “Kërkesën për kuotim”, në përputhje me nenet 22 dhe 40 të ligjit të sipërpërmendur, kur vlera e përllogaritur e kontratës të jetë jo më e madhe se 2 (dy) milionë lekë për prokurimin e ndërtimeve, 1 (një) milionë lekë për mallrat dhe 500 000 (pesëqind mijë) lekë për prokurimin e shërbimeve.

4. Enti prokurues të përdorë “Prokurimin e drejtpërdrejtë”, në përputhje me nenin 19 të ligjit të sipërpërmendur kur:

a) Pika 1/b/c/ç për vlerë jo më të madhe se 30 për qind e kontratës fillestare, kur nevoja për këtë shtesë del brenda afatit të kolaudimit të punimeve për ndërtimet dhe brenda 3 muajve nga afati i mbarimit të kontratës për mallrat dhe shërbimet.

b) Pika 2, për mallrat me vlerë të vogël se mallrat e gatshme, kur vlera e përllogaritur e blerjes për çdo artikull nuk është më e madhe se 200 000 (dyqind mijë) lekë, brenda një viti kalendarik.

c) Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare vlera e përllogaritur e blerjes për çdo artikull nuk është më e madhe se 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, brenda një viti kalendarik.

5. Dita e shpalljes së ftesës për ofertë deri në ditën e dorëzimit të saj të jetë:

a) Për “Tenderin e hapur” të jetë jo më pak se 20 (njëzetë) ditë për prokurimin e ndërtimeve, të mallrave dhe të shërbimeve.

b) Për “Tenderin e kufizuar” jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për prokurimin e ndërtimeve, të mallrave dhe të shërbimeve.

c) Për “Kërkesën për kuotim” jo më pak se 10 (dhjetë) ditë për prokurimin e ndërtimeve, të mallrave dhe të shërbimeve.

ç) Për procedurat ndërkombëtare jo më pak se 45 (dyzetepesë) ditë.

6. Kushti i sigurimit të ofertave, në formë garancie bankare, sipas nenit 29 të ligjit, do të jetë 2-5 për qind e vlerës së përllogaritur të kontratës (e llogaritur paraprakisht nga enti prokurues dhe e dhënë në vlerë absolute në të dhënat e ofertës), kurse kushti i sigurimit të kontratës do të jetë 10 për qind e vlerës së kontratës.

7. Enti prokurues, përpara se të shpallë ofertën ose propozimin fitues, të paraqesë, për shqyrtim paraprak e miratim, raportin përmbledhës të prokurimeve:

a) Te titullari i entit prokurues, për të gjitha prokurimet me vlerë nën 5 (pesë) milionë lekë.

b) Te titullari i organit qendror ose vendor për prokurimet me vlerë mbi 5 (pesë) milionë lekë.

c) Tek Agjencia e Prokurimit Publik për prokurimet me vlerë mbi 100 (njëqind) milionë lekë.

8. Pjesëmarrësi në tender i shpallur fitues duhet t'i deklarojë entit prokurues, nëpërmjet

nënshkrimit të formularit të kontratës, gatishmërinë për të lidhur kontratën brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, për tenderin e hapur dhe të kufizuar, dhe ftesës për kuotim dhe për tenderin e hapur dhe të kufizuar ndërkombëtar.

Në rast se brenda këtij afati, përgjigja nga pjesëmarrësi fitues është negative, entit prokurues i lind e drejta të njoftojë për negociimin e kontratës pjesëmarrësin që është renditur i dyti në klasifikim dhe njëkohësisht të bëjë konfiskimin e sigurimit të ofertës për pjesëmarrësin fitues.

9. Enti prokurues është i detyruar të krijojë regjistrin e prokurimeve në fillim të çdo viti, ku të shënohet rregullshmëria e zbatimit të procedurave të prokurimit.

10. Të gjitha entet prokuresse të dërgojnë për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik ftesën për ofertë të tenderit të hapur, të tenderit të kufizuar dhe ftesë për kuotim, jo më vonë se 10 ditë përpara shpalljes së saj. Gjithashtu, për tenderat që do të botohen në Buletinin e Prokurimit Publik enti prokurues është i detyruar që, përpara lidhjes së kontratës, të bëjë njoftimin e fituesit në Buletinin e Prokurimit Publik.

11. Enti prokurues, brenda datës 30 janar të paraqesë në Agjencinë e Prokurimit Publik statistikën e sakta për planifikimin vjetor të prokurimeve. Gjithashtu, të paraqiten pranë Agjencisë së Prokurimit Publik edhe ndryshimet e planit të prokurimeve publike gjatë vitit kalendarik. Enti prokurues në fund të çdo tremujori, brenda datës 10 të muajit pasardhës, të paraqesë në Agjencinë e Prokurimit Publik një tregues për realizimin apo jo të prokurimeve të planifikuara, të shoqëruar me relacionin shpjegues. Ndërsa Agjencia e Prokurimit Publik brenda datës 20 të po atij muaji duhet të paraqesë në Këshillin e Ministrave një pasqyrë përmbledhëse të prokurimeve në shkallë vendi.

12. Çdo kandidat është i lirë të kërkojë shqyrtim administrativ për një veprim apo shkelje të kryer nga një ent prokurues, kur e vlerëson si shkelje të ligjit ose të rregullave të prokurimit, brenda këtyre afateve:

a) Në entin prokurues dhe në organin qendror ose vendor brenda 5 (pesë) ditëve pas shpalljes së klasifikimit përfundimtar të ofertave.

b) Në Agjencinë e Prokurimit Publik 5 (pesë) ditë pas mbarimit të afatit të ankesës pranë entit prokurues.

13. Në rastet kur një procedurë prokurimi kthehet për rivlerësim nga Agjencia e Prokurimit Publik, enti prokurues është i detyruar që brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij vendimi të paraqesë në Agjencinë e Prokurimit Publik, raportin përmbledhës të rivlerësimit.

14. Enti prokurues duhet të ruajë dhe të vërë në dispozicion të organeve të kontrollit regjistrin e prokurimeve, procesverbalet dhe dokumentacionin e plotë të të gjitha prokurimeve të kryera. Ruajtja e këtij dokumentacioni të bëhet në përputhje me afatet e përcaktura në ligjin “Për arkivat”.

15. Vendimi nr.12 datë 01.01.1996, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

VENDIM

Nr.336, datë 23.6.2000

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.199, DATË 22.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RRIJTJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, pika 2, të ligjit nr.8487, datë 12.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, nenit 2, pika 4, të ligjit nr.8456, datë 11.2.1999, “Për funksionimin e përfaqësuesit ligjor pranë organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, dhe të nenit

18, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.199, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

Në lidhjen nr.1, në fund të pikës B2, shtohen emërtimet:

“- Përfaqësues ligjor pranë organizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

- Përfaqësuesi i zyrës së minoriteteve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.337, datë 23.6.2000

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS LINDORE TË URUGUAIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE, ZYRTARE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Lindore të Uruguait, për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.339, datë 23.6.2000

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR” NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.516, DATË 14.11.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.516, datë 14.11.1999, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 69.2 shtohet pika 69.3, me këtë përmbajtje:

“69.3 Çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar, për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë me të drejtën e riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t'i shtohen e drejta e pronësisë intelektuale (royalties) dhe e drejta e licensës (licence fee).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

U D H Ë Z I M

Nr.1927, datë 15.06.2000

PËR PAJISJEN ME TARGA TË MJETEVE TË TRUPIT DIPLOMATIK

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 129, pika 2 të ligjit nr,8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë“, Ministri i Transportit,

U D H Ë Z O N:

1. Targat e mjeteve të Trupit Diplomatik të akredituara në Republikën e Shqipërisë do të lëshohen vetëm mbas përcaktimit të statusit të tyre nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, dërguar zyrtarisht prej saj, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRr).

2. Regjistrimi, targat dhe lejet e qarkullimit për mjetet e Trupit Diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë do të lëshohen nga DPSHTRr, zyra përkatëse në Drejtorinë Rajonale të Tiranës.

3. Për dhënien e tyre, në marrëdhënie me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Përfaqësitë Diplomatike, do të jenë në fuqi procedurat administrative dhe dokumentare në fuqi, ndërsa veprimtaria e zyrës së shprehur në pikën 2, të përcaktohet me akt të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Për gjithë praktikën e zbatuar për këtë qëllim, nga ana e zyrës përkatëse në DPSHTRr, të mbahet arkiv i veçantë.

5. Targat për mjetet e shërbimit të Trupit Diplomatik do të jepen të ndara si më poshtë:

a. Targat me shkronat CD dhe ngjyrë jeshile do t'u jepen Përfaqësive Diplomatike dhe atyre të Organizatave Ndërkombëtare të akredituara në Shqipëri si dhe mjeteve private të personelit diplomatik të tyre, sipas përcaktimit të pikës 1.

b. Targat me shkronjat TR dhe ngjyrë jeshile do t'u jepen mjeteve private të personelit administrativ dhe teknik të përfaqësive diplomatike dhe atyre të Organizatave Ndërkombëtare të akredituara në Shqipëri, sipas përcaktimit të pikës 1.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT

Sokol Nako